Spaletat mbi supe duhet të jenë me dimensione 11,5 cm x 5.5 cm. Çdo spaletë duhet të përfundojë me një pullë, duke pasur kujdes për të siguruar që spaleta të jetë e vendosur në qendër të supeve. Shiritat e spaletave duhet të jenë qepur 5 mm nga buza.

Mbërthimi (mbyllja me kopsa)
Mbërthimi i këmishës duhet bërë me jo më pak se shtatë (7) kopsa.

Mëngët
Këmisha me mëngë të gjata duhet të ketë një hapje prej 18 cm, Mansheta duhet të jetë 7 cm e thellë, me buzë të qepura 5 mm nga skaji dhe që duhet mbërthyer përmes me një kopsë.

Pjesët e theksuara të xhepit të gjoksit
Duhet të jenë 2 xhepa të theksuar të gjoksit. Xhepi duhet të jetë me dimensione 13.5 cm i gjerë dhe 13 cm i thellë. Kapaku i xhepit është i gjate 14 cm, masat anësore janë 4 cm, 5 cm në qendër të kapakut të xhepit. Kapaku i xhepave mbërthehet me një kopsë. Fundi i pjesës së xhepit duhet të jetë me cepa të prerë.

Pjesa e shpinës
Pjesa e shpinës (supeve) duhet të jetë 9 cm poshtë nga qendra e qafës.

KËMISHA PUNE ME MËNGË TE SHKURTRA FEMRA



PËLHURA

MATERIALI BAZË
Skeda teknike

MATERIALET E TJERA

Mes – astari
Jaka, manshetat dhe kapakët e xhepave duhet të jenë pajisura me mes - astar të mesëm (i vendosur në mes të pëlhurave) nga materiale që nuk tkurren.

Kopsat
Kopsat duhet të jenë me katër vrima për qepje.

DIZAJNI

Shiriti ballor
Pjesa e përparme e këmishës duhet të jetë e punuar me një shirit me gjerësi 3 cm. Buza e pjesës ballore duhet të jetë qepur 5 mm.

Tegelat e qepura ne pjesën e përparme
Secila pjesë e përparme e këmishës duhet të ketë të qepur nga një tegel, duke filluar nga buza e qepur e supeve për të kaluar përmes qendrës se xhepit në gjoks.

Jaka
Jaka e punuar duhet të jetë moderne dhe të ketë një gjerësi mesatare. Jaka duhet të jetë e qepur 5 mm nga buza.

Spaletat
Spaletat mbi supe duhet të jenë me dimensione 10.5 cm x 4.5 cm. Çdo spaletë duhet të përfundojë me një pullë, duke pasur kujdes për të siguruar që spaleta të jetë e vendosur në qendër të supeve, shiritat e spaletave duhet të jenë qepur 5 mm nga buza.

Mbërthimi (mbyllja me kopsa)
Mbërthimi i këmishës duhet bërë me jo më pak se shtatë (7) kopsa.

Mëngët
Këmisha është me mëngë të shkurtra.

Pjesët e theksuara të xhepit të gjoksit
Duhet të jenë 2 xhepa të theksuar të gjoksit. Xhepi duhet të jetë me dimensione 12.5 cm i gjerë dhe 12 cm i thellë. Kapaku i xhepit është i gjatë 13cm, masat anësore janë 3.5 cm, 5.5 cm në qendër të kapakut të xhepit. Kapaku i xhepave mbërthehet me një kopsë. Fundi i pjesës së xhepit duhet të jetë me cepa të prerë.

Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja	**ISO 1833**	60% Pambuk 40% Poliester
Ngjyra		Bojëqielli
Masa	**EN 12127**	114g/m^2 (± 5 g)
Dendësia	**UNI EN 1049/2**	45*45
Numri i fijeve		TELA POUPLIN
Stabiliteti dimensional pas larjes në 40°C	**EN ISO 26330**	Vertikal: ± 2% Horizontal: ± 2%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	**EN ISO 105 B02**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	**ISO 105-C01**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	**ISO 105-X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	**ISO 105-X12**	3 - 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës, acideve dhe alkaleve	**ISO 105-E04**	4

AKSESORË

GRADA

Gradat e supeve janë të vendosura në spaletat e këmishës dhe janë me dimensione 60 mm*90 mm*58 mm sipas rangut përkatës.

BLUZE ME MENGË TË SHKURTRA POLO ME DY NGJYRA



SPECIFIKIMET TEKNIKE MATERIALI BAZË BLU E ERRËT

Nr.	METODA	SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TRIKOTAZHIN E BLUZËS POLO ME MËNGË TË SHKURTRA	
1	ISO 3801:2013	Përcaktimi i Masës	260 g/m2± 5%
2	ISO 7211/1:1984	Përcaktimi i llojit të thurjes	Syth Irlandez
3	ISO 1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	80% CO 20%PES
4	ISO 105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit ndaj larjes në 40°C	NOTA 4-5
5		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	

SPECIFIKIMET TEKNIKE MATERIALI SHTESË

Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja	**ISO 1833**	60% Pambuk 40% Poliester
Ngjyra		Bojëqielli
Masa	**EN 12127**	114g/m² (± 5 g)
Dendësia	**UNI EN 1049/2**	45*45
Numri i fijeve		TELA POUPLIN
Stabiliteti dimensional pas larjes në 40°C	**EN ISO 26330**	Vertikal: ± 2% Horizontal: ± 2%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	**EN ISO 105 B02**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	**ISO 105-C01**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	**ISO 105-X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	**ISO 105-X12**	3 - 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës, acideve dhe alkaleve	**ISO 105-E04**	4

Pjesët përbërëse të bluzës:

- PJESËT PERPARA DHE MBRAPA PËRPARA
- JAKA
- MËNGËT E SHKURTRA

1.PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Si përpara ashtu edhe mbrapa bluza duhet të ndërtohet nga dy pjesë, të sipërmet me ngjyrë bojeqielli që fillojnë tek linja e supeve dhe përfundojnë rreth 19 cm poshtë ne pjesen mrapa (shpina) dhe pjesët e poshtme me ngjyrë blu të errët. Pjesa e copes bojëqielli është e mbivendosur dhe e qepur me tegel një gjilpërësh. Pjesa e përparme e plotë dhe ajo e pasme e plotë duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh të përforcuar nga brenda me tegel syzator. Në fund bluza duhet të mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2.5 cm. Palosja duhet të qepet me tegel syzator dy gjilpërësh. Pjesët "e çara" anësore duhet të jenë të larta 4 cm dhe duhet të përforcohen me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor nga secila anë e buzës. Fundi i bluzës duhet të jetë i drejtë dhe duhet të ketë të njëjtën gjatësi në të dyja anët.

*Në linjën e supeve jane spaletat që përfundojnë me kulm me majë me dimensione 15 cm*5 cm. Spaleta mbyllet me kopsë plastike .*

2.JAKA

Jaka duhet të ndërtohet me tekstil trikotazh me thurje llastik 1:1 me drejtim vertikal dhe lartësi standarde 8 cm.

Bashkimi i dy pjesëve të bluzës duhet të bëhet me anë të një filetoje prej pambuku me gjerësi rreth 1 cm. Qepja e filetos tek jaka dhe tek bluza duhet të bëhet me anë të dy tegelave linearë një gjilpërësh. Ajo duhet të fillojë dhe të mbarojë tek gjysma e gjerësisë së bordurave të kopsave dhe vrimave të kopsave.

Bordura e kopsave të masës M për meshkujt duhet të ketë përmasa 4x14 cm , ndërsa për femrat 3 x 13 cm. pjesa e poshtme e bordurës së kopsave është mbivendosur copë bojëqielli .

3.MËNGËT

Mëngët duhet të përbëhen nga dy pjesë tekstili. Tekstili bojëqielli është i mbivendosur në pjesën e sipërme të mëngës dhe përfundon deri te llastiku i mngës.

Përmasat e mëngës duhet të ndryshojnë në varësi të masës së bluzës.

Mënga duhet të mbyllet me tekstil trikotazh me thurje "llastik" 1:1 me drejtim vertikal (i njëjtë me atë të jakës) me lartësi rreth 2 cm.

Tekstili trikotazh duhet të bashkohet me mëngën me tegel linear dy gjilpërësh dhe të përforcohet nga brenda me tegel syzator

AKSESORËT

SHENJA KRAHU

a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e **POLICISE SE BURGJEVE.**

b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.

c.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit.

GRADA

Gradat e supeve janë të vendosura në spaletat e xhaketës dhe janë me dimensione 60 mm*90 mm*58 mm sipas rangut përkatës.

PULOVER JAKË NË FORMË "V" PER FEMRA E MESHKUJ

Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja e materialit	**ISO 1833**	50% Lesh (± 3%) 50% Akrilik (± 3%)
Ngjyra		Blu e errët
Masa e puloverit te përfunduar		500-600gr
Endja	**ISO 2060/72**	1*1
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	**EN ISO 105 B02**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	**ISO 105-C01**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	**ISO 105-X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	**ISO 105-X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës, acideve dhe alkaleve	**ISO 105-E04**	4

Pulovër me jakë në formë V-je

Pulovra duhet të ketë përbërje 50 % Leshi dhe 50% Akriliku.
Jaka e pulovrës duhet të jetë në formë "V".

Pjesët përbërëse të pulovrës:

- PJESA E PËRPARME
- PJESA E PASME
- JAKA
- MËNGËT E GJATA

PJESËT PËRPARA DHE PJESET E PASME

Pjesa e përparme dhe e pasme duhet të thuren të plota (pa ndërprerje), me punim trikotazhi. Thurja llastik 1:1 duhet të jetë elastike dhe të mos zgjerohet apo deformohet gjatë përdorimit.

JAKA

Bordura e jakës duhet të jetë me punim trikotazhi me thurje llastik 1:1. Gjerësia e bordurës së jakës duhet të jetë 2 cm. Gjatësia e brinjës së trekëndëshit të bordurës së jakës duhet të jetë 20 cm. Bordura e jakës duhet të jetë e bashkuar dhe e palosur me trupin e pulovrës me anë të makinerive të posaçme të trikotazhit.

MËNGËT E GJATA

Mëngët e gjata duhet të jenë të plota (pa ndërprerje), me punim trikotazhi me thurje llastik 1:1 në 7 cm dhe thurje interlock në të gjithë pjesën tjetër.

AKSESORËT

a.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit

b.) Në krahun e majtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset grada e gjoksit sipas rangut për-katës.

XHUBOKS ME NGJYRË BLU
PËR MESHKUJ DHE FEMRA



Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja e materialit të jashtëm	**ISO 1833**	94 Poliester 6% Spandeks (± 3%)
Ngjyra		Blu e errët
Masa	**UNI ISO 12127**	≥ 97 ≤ 115 g/m²
Thurja	**UNI 8099**	Saia nga 3 fije
Numerimi i fijeve	**ISO 9275**	Vertikal: 78 Dtex Horizontal: 78Dtex
Zvogëlimi në cm	**UNI EN 1049 -2**	Vertikal: ≥ 43 ≤ 51 Horizontal: ≥ 29 ≤ 37

Shtresa Funksionale

Kompozicioni		*Membrane PTFE*
Përbërja e materialit laminat		
Masa	*UNI ISO 12127*	*≥ 145≤ 170g/m²*
Rezistenca ndaj ujit	*UNI EN ISO 31092*	*Ret ≤ 11m² Pa/W*
Stabiliteti dimensional pas 30 larje me normen UNI ISO 6330 4N	*UNI EN ISO 9237*	*≤ 5 mm/s*
Rezistenca ndaj terheqjes	*ISO 13934*	*Vertikal: 600 N* *Horizontal: 600N*
Zvogelimi në cm		*Vertikal: ≥ 9 ≤ 17* *Horizontal: ≥ 12≤ 20*
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	*EN ISO 105 B02*	*5*
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	*ISO 105- C10 prova 3*	*4*
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	*ISO 105- X12*	*4*
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	*ISO 105- X12*	*4*
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj acideve, djersës dhe alkaleve	*ISO 105-E04*	*5*

PËRSHKRIMI

Xhuboksi ngjyrë blu përbëhet nga këto elementë:

- PËRPARA
- PJESA E PASME
- JAKA
- KATËR XHEPA
- DY MËNGË
- FILETO NGJYRË BLU

1. Përpara

Përpara xhuboksi është i realizuar me prerje. Pjesët bashkohen ndërmjet tyre në linjën qendrore në drejtim vertikal me anë të zinxhirit të dukshëm tip 8 dhëmbësh; i montuar përgjatë gjithë gjatësisë së xhuboksit. Në brendësi të veshjes në të djathtë të veshur, po në afërsi të zinxhirit është montuar një mostër me tekstil të njëjtë me atë të xhuboksit, me gjerësi rreth 4,5 cm e realizuar me tegel qepës linear një gjilpërësh në drejtim vertikal.
Në secilën nga pjesët përpara në lartësinë e linjës së belit është montuar një xhep fileto me lartësi rreth 2,5 cm në drejtim transversal me hapje rreth 18 cm. Xhepi fileto është montuar me tegel linear një gjilpërësh në drejtim transversal. Në brendësi të xhepit fileto është montuar zinxhiri me ngjyrë blu i cili shërben për hapjen dhe mbylljen e xhepit. Gjithashtu në linjën e gjoksit është montuar një xhep sportiv me lartësi rreth 20,5 cm, hapja dhe mbyllja e të cilit realizohet me anë të zinxhirit me ngjyrë blu të montuar në drejtim vertikal në distancë rreth 3 cm nga ana e brendshme e xhepit. Xhepi është modeluar në formën e shkronjës "D" dhe është montuar me tegel një gjilpërësh. Zinxhiri ka gjatësi rreth 16 cm dhe është montuar në të gjitha drejtimet me tegel një gjilpërësh. Në linjën e kraharorit në secilën pjesë para në drejtim vertikal është realizuar nje prerje e cila vazhdon përgjatë mëngëve ne te cilen eshte qepur fileto ngjyre blu. Bashkimi i dy pjesëve realizohet me anë të tegelit një gjilpërësh me një fileto 4 mm.
Linja fundore e pjesëve para dhe pjesës së pasme është realizuar me kthim pale me lartësi rreth 2 cm në brendësi të së cilës është ndërfutur një llastik në formë kordoni me kapëse për modifikimin e (perimetrit) gjerësisë të pjesës së poshtme.

2. PJESA E PASME

Është e realizuar me prerje përgjatë linjës së shpatullave pas me vazhdim në të gjithë gjatësinë e mëngës si në pjesët përpara dhe eshte qepur nje fileto ngjyre blu. Gjithashtu në linjën qendrore është realizuar një prerje deri në linjën e shpatullave. Montimi i pjesëve është realizuar me tegel qepës një gjilpërësh me hap tegeli 5 mm me fileto 4 mm .

3. JAKA

Jaka është model Korean realizuar me tekstil të njëjtë me të xhiboksit. Montimi i jakës është realizuar me tegel një gjilpërësh në tre drejtimet. Në pjesën e sipërme të jakës është montuar një bordurë me lartësi rreth 20 mm me tekstil të njëjtë e montuar me tegel qepës dy gjilpërësh.

4. MËNGËT

Janë realizuar me të njëtin tekstil si pjesët e tjera të xhuboksit. Secila mëngë është realizuar me dy pjesë të modeluara me vazhdim në pjesën e kraharorit përpara dhe linjën e shpatullave pas. Pjesët montohen me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Linja fundore e secilës mëngë përfundon me kthimin e palës rreth 2 cm realizuar me tegel qepës një gjilpërësh.
Në linjën fundore të secilës mëngë është aplikuar një almar me gjatësi rreth 8,5cm me tekstil dopio të njëjtë me xhuboksin. Në skajin e brendshëm të almarit është montuar një shirit velkrofi "mashkull" me dimesione 2x2 cm në korrespondencë me velkrofin drejtkëndor të montuar në bordurën e mëngës për funksion përshtatje të mëngës së xhuboksit me perimetrin e kyçit të dorës. Velkrofi i montuar në bordurën e mëngës ka dimensione 2x14 cm.

AKSESORËT

SHENJA KRAHU

a.)
*Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e POLICISË SË BURGJEVE.*

b.)
*Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.*

c.)
*Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit.*

KOSTUMI RIP-STOP PËR POLICINË E BURGJEVE
BLU E ERRËT





	*** Qëndrueshmëria në pastrim kimik ISO 105 DO1**			
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës	4.0			C.I.S 4.0
	*** Qëndrueshmëria në fërkim ISO 105 X12**			
	në të thatë:	në të njomë:		në të thatë: 4-5
	4.0	3.0		në të njomë: 4.0
	*** Stabiliteti dimensional në larje ISO 6330 2A**			
	Baza:	-2.0%		-3.00%
	Indi:	**-1.0%**		-3.00%
	*** Stabiliteti dimensional I trikotazheve AATCC 179 Opt:1**			
	Ndryshimi	1.4%		2.00%
	*** Qëndrueshmëria në terheqje ISO 13934-2**			
	Qëndrueshmëria e bazës :	78.5 Kg		15 Kg
	Qëndrueshmëria e Indit :	52 Kg		15 Kg
	*** Qëndrueshmëria në grisje ISO 13937-1**			
	Qëndrueshmëria e bazës :	46 N		20 N
	Qëndrueshmëria e Indit :	52 N		20 N
	*** Qëndrueshmëria në grisje e tegelit qepës ISO 13936-1**			
	Tegeli në drejtim të bazës :	Hapi i tegelit: 6 mm		6mm @ 12 kg
	Tegeli në drejtim të indit :	Hapi i tegelit: 6 mm		6mm @ 12 kg
	*** Vonuesit e flakës ISO 11612**			
	Kalon			Initial
	0			
	Kalon			A/50 Larje
	*** Abrazion (Martindale) ISO 12947-2**			9 Kpa @ 20000 Cycles
	Thread not broken			

							STANDARDI
*** Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë ISO 105 B02**							
Ndryshimi I ngjyrës: 4.0							4.0
*** Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë ISO 105 B07**							
Ndryshimi I ngjyrës: 4-0							4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
***Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje ISO 105 C06 E2S**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Viskozë	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në ujë të kloruar ISO 105 N01**							C.I.S 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës			4.0				Njollosja 4.0
*** Qëndrueshmëria në ujë ISO 105 E01**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në djersë ISO 105 E04 Acide**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në djersë ISO 105 E04 Alkaline**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							

*** Qëndrueshmëria ne piling ISO 12945-2 @ 2000 Cycles**	
4.0	4 - 5
*** Masa për njësi të sipërfaqes ASTM-D 3776**	
206.7 g/m2	205 +/-5 g
*** Përmbajtja e Formaldehideve ISO 14184-1**	
40 ppm	< 75 ppm
*** Testi i pH-it ISO 3071**	
7.4	4.5-7.5
*** Përbërja e pëlhurës AATCC-20/A/20**	
PC	PC
***Gjerësia përfundimtare ASTM-D 3774**	
58.5"	58"/59"
*** Zgjatimi ASTM-D 3107**	
11.0%	12-16%
***Zgjatimi plastik ASTM-D 3107**	
2.5%	
*** Zgjatimi elastik ASTM-D 3107**	
76.0%	
*** Depërtueshmeria e ujit ISO 4920**	
100	A/5 Wash 70
*** Depërtueshmeria e vajrave ISO 144194**	
100	A/5 Wash 70

PËRSHKRIMI

Eshtë realizuar me tekstil rip stop ngjyrë blu dhe përbëhet nga këto elementë:

— 1/XHAKETA

1/XHAKETA

Xhaketa është model monopetë, ngjyrë blu të errët dhe përbëhet nga këto elementë:

- Përpara (me prerje në linjën qendrore me dy pjesë)
- Pjesa pas
- Jaka
- Dy mëngë të gjata

1. PËRPARA

Është realizuar me dy pjesë; të bashkuara ndërmjet tyre përgjatë linjës qendrore në drejtim vertikal. Pjesët përpara bashkohen me njëra – tjetrën nëpërmjet pesë kopsave plastike me ngjyrë në tonalitet me tekstili, të montuara në të majtë të veshur në paramonturë; qepje kryq e kopsës, në korrespondencë me vrimat e aplikuara në bordurën e montuar në të djathtë të veshur. Paramontura ka gjerësi rreth 4,5 cm me gjatësi deri në linjën fundore të xhaketës. Po ashtu në brendësi të paramonturës është montuar zinxhiri me ngjyrë blu, me gjatësi rreth 55 cm. Zinxhiri është montuar me tegel një gjilpërësh. Bordurat përpara janë montuar me trupin e xhaketës me tegel qepës dy gjilpërësh, ndërsa në anët e lira janë përshkruar me tegel një gjilpërësh. Secila pjesë përpara bashkohet me jakën me tegel një gjilpërësh; ndërsa në linjat e supeve, mëngët dhe linjat anësore nëpërmjet tegelit linear dy gjilpërësh. Linja fundore e xhaketës përfundon me një kthim pale rreth 20 mm lartësi me anë të tegelit një gjilpërësh.

Xhepa të vegjël në linjën e gjoksit

Në linjën e gjoksit janë montuar dy xhepa që përfundojnë me kulm me majë, me kapakë me kulme ndërsa pjesa e sipërme e xhepit paraqet një kthim pale me lartësi rreth 2 cm. Xhepat kanë përmasa: lartësi 14,5 cm, gjerësi 14 cm. Montimi i kapakëve me trupin e xhaketës dhe tre drejtimet e lira janë realizuar me anë të tegelit linear një gjilpërësh. Kapakët janë montuar me kulme dhe përshkuar në të gjitha drejtimet me tegel një gjilpërësh. Në afësi të kulmit të kapakut është aplikuar një vrimë në drejtim vertikal me hapje rreth 25 mm, në korrespondencë me kopsën plastike me ngjyrë blu të montuar me qepje kryq në bordurën e sipërme të xhepit.
Në linjën e jashtme janë montuar xhepa të fshehtë, hapja dhe mbyllja e të cilëve realizohet me anë të zinxhirëve të aplikuar në secilën pjesë përpara. Zinxhiri ka gjatësi rreth 16 cm dhe është montuar me tegel një gjilpërësh në të gjitha drejtimet.

Xhepat në pjesën e poshtme

Në dy pjesët përpara gjithashtu është montuar një xhep i poshtëm, që përfundon me kulme me dimensione 18x16 cm me shtesë gjerësie në anësor. Xhepi është montuar në tre drejtimet me anë të tegelit qepës një gjilpërësh, ndërsa pjesa e sipërme e tij paraqet një palosje me lartësi rreth 2 cm. Mbi xhep është montuar një kapak me kulme i montuar me tegel një gjilpërësh dhe i përshkruar me të njëjtin tegel në tre drejtimet e lira. Në afërsi të kulmit të kapakut, përgjatë qendrës është montuar një vrimë në drejtim vertikal me hapje rreth 25 mm në korrespondencë me kopsën plastike me ngjyrë blu të montuar në bordurën e sipërme të xhepit.

2. PJESA E PASME

Pjesa pas e xhaketës është me prerje përgjatë linjës qendrore dhe përfundon në fund me një kthim pale rreth 2 cm lartësi. Pjesët bashkohen në drejtim vertikal me anë të tegelit dy gjilpërësh. Në secilën anë të pasme në distancë rreth 5,5 cm nga linja e supit është aplikuar një palë e hapur tekstili me gjerësi rreth 4 cm, me vazhdim deri në linjën e belit për lirshmëri më të mirë të xhaketës e përshkuar me tegel dy gjilpërësh dhe e përforcuar në dy bordet.
Përgjatë linës së belit të xhaketës në pjesën e brendshme të saj janë ndërfutur shiritë tekstili me kulme me majë në të cilën janë aplikuar dy vrima në distancë nga njëra tjetra në korrespondencë me kopsën e montuar në tegelin anësor, për përshtatje të formës trupore.

3. MËNGËT

Xhaketa është e përbërë nga dy mëngë të gjata të modeluara me dy pjesë. Montimi i mëngës realizohet ne tegel të poshtëm dhe tegel anësor dy gjilpërësh në drejtim horizontal. Mëngët përfundojnë me kapak me lartësi rreth 6,5 cm e montuar me trupin e mëngës me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Njëri skaj i kapakut përfundon me kulm me majë dhe në distancë rreth 2 cm është montuar një vrimë horizontale me hapje rreth 25 mm. Gjithashtu në tegelin anësor me pikënisje nga fundi i kapakut është aplikuar një hapje me gjatësi rreth 10 cm dhe në distancë 3,5 cm është realizuar një pencë. Në distancë rreth 8,5 cm në secilën mëngë është montuar velkrof femër me përmasa 15,5x10 cm për vendosjen e stemës.

4. JAKA

Jaka e xhaketës është realizuar model klasik me tekstil dopio, baza e të cilës montohet me pjesët përpara dhe pjesën pas me anë të tegelit linear një gjilpëresh. Tre drejtimet e lira janë përshkuar me anë të tegelit linear perimetral. Jaka ka lartësi rreth 8 cm.

5. SPALETAT

Baza e spaletës në secilën pjesë është montuar në kokën e mëngës. Spaleta ka përmasa: 29 x 5 cm me vazhdimësi përgjatë pjerrësisë së supit. Është realizuar me të njëjtin tekstil si ai i xhaketës. Spaleta është modeluar me kulme në pjesën fundore të saj; është aplikuar vrimë horizontale me hapje 25 mm në korrespondencë me kopsën plastike me ngjyrë blu të montuar në bazamentin e spaletës. Spaleta qëndron e palosur me anë të kalimit të saj në ylykun e montuar në trupin e xhaketës.Ne pjesen e siperme te spaletave eshte qepur fileto me ngjyre blu.

AKSESORËT

Shenja Krahu

*a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e POLICISE SE BURGJEVE*

*b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.*

*c.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit.*

GRADA

*Gradat e supeve janë të vendosura në spaletat e xhaketës dhe janë me dimensione 60 mm*90 mm*58 mm sipas rangut përkatës.*

2/PANTALLONA

Pantallonat e dokut janë realizuar me tekstil ngjyrë blu dhe përbëhen nga këto elementë:

- Qemeri
- Dy xhepa oblig klasikë të montuar përgjatë linjave anësore
- Një xhep fileto në të djathtë të veshur
- Një xhep drejtkëndor me kapak në të majtë të veshur
- Dy këmbë
- Dy xhepa kargo
- Dy xhepa fileto

1. QEMERI

Është realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 5 cm, i bashkuar me trupin nëpërmjet tegelit qepës një gjilpërësh. Në të majtë të veshur të qemerit është aplikuar një vrimë horizontale me gjerësi rreth 2,5 cm. Në korrespondencë me të në të djathtë të veshur është montuar një buton metalik me ngjyrë të zezë. Gjithashtu në linjë me kopsën e vrimën në brendësi të secilës anë në qemer janë montuar velkroët "mashkull" femër" formë katrore me përmasa 4x4 cm, për hapjen dhe mbylljen e qemerit. Në lartësinë e qemerit përgjatë perimetrit janë aplikuar 5 kalues me përmasa: gjerësi rreth 2,5 cm lartësi rreth 7 cm të pozicionuar përkatësisht;

*

Tre kalues të montuar në pjesët pas

*

Dy kalues në pjesën përpara

Kaluesit janë përshkruar përgjatë qendrës me tegel dy gjilpërësh dhe fiksuar në trupin e pantallonave në bordurat e sipërme dhe të poshtme. Kaluesi në të majtë të veshur përfundon me një ylyk me ngjyrë të zezë.

Në linjën qendrore përpara është montuar sallkia me gjerësi rreth 3 cm dhe lartësi deri në linjën e qemerit rreth 7 cm. Ana e majtë e veshur e sallkisë në lartësinë e qemerit vazhdon me një bordurë shtesë si tek kampioni zyrtar. Në brendësi të sallkisë është montuar zinxhiri me ngjyrë blu. Sallkia është montuar me trupin me anë të tegelit një gjilpërësh dhe përshkruar në bordurën anësore me tegel dy gjilpërësh. Në pjesën e pasme të qemerit është aplikuar llastik për t'ju përshtatur formës trupore.

2. KËMBËT

Secila këmbë është realizuar nga dy pjesë, një pjesë e përparme dhe një e pasme, të bashkuara me tegel qepës dy gjilpërësh në drejtim vertikal në linjën anësore nga jashtë këmbës, ndërsa nga brenda këmbës janë bashkuar me tegel një gjilpërësh.

Këmbët e pantallonit përfundojnë me një kthim pale rreth 20 mm lartësi realizuar me tegel një gjilpërësh. Në pjesët përpara nën xhepin kargo në pantallona është realizuar një prerje në formë arne drejtkëndore sipas gjerësisë së pantallonave. Arna ka lartësi rreth 29 cm dhe është përshkuar në anën e sipërme dhe të poshtme me tegel dy gjilpërësh ndërsa anësoret janë montuar në tegelat bashkues të pantallonave. Në secilën anë në drejtim horizontal janë aplikuar katër tegela qepës në formë pence me gjatësi rreth 7 cm. Në pjesën e pasme është realizuar një prerje në distancë rreth 5 cm nga bordet e qemerit përgjatë qendrës pas dhe linjat anësore. Pjesët pas në qendër janë montuar me tegel qepës dy gjilpërësh.Ne pjesen e kembve eshte qepur fileto me ngjyre blu nga fundi i xhepit Kargo deri ne fund te pantallonave.

Xhepi fileto në të djathtë të veshur

Xhepi fileto është realizuar në distancë rreth 5,5 cm nga bordura fundore e qemerit. Fileto e xhepit paraqet lartësi rreth1,5 cm dhe me hapje (gjerësi) rreth 10,5 cm. Mostra e filetos është montuar me tegel një gjilpërësh dhe e përforcuar në anët.

Trasta e xhepit është realizuar me mostër të njëjtë dhe në brendësi të saj është montuar një shirit me ngjyrë të zezë, me gjerësi rreth 25 mm. Shiriti me gjatësi rreth 23 cm përfundon me një preçinë në korrespondencë me preçinën e montuar në trupin e pantallonave për fiksimin e saj.

Xhep drejtkëndor me kapak në të majtë të veshur

Xhepi drejtkëndor është montuar në distancë rreth 5 cm nën linjën fundore të qemerit dhe distancë rreth 8 cm nga linja anësore. Xhepi është modeluar në formë libri, drejkëndor me dimensione 14x9 cm. Në linjën fundore është bashkuar me tegel dy gjilpërësh ndërsa në anësor me tegel një gjilpërësh. Xhepi paraqet një bordurë me lartësi rreth 2 cm në qendër të së cilës është montuar velkrofi 'mashkull" në korrespondencë me velkrofin "femër" të montuar në kapak, të cilët shërbejnë për hapjen e mbylljen e xhepit me kapakun. Kapaku ëhshtë modeluar me kulme dhe përshkuar në të gjitha drejtimet me tegel dy gjilpërësh. Në brendësi të pjesës fundore të kapakut është montuar velkrofi me dimensione 2x4 cm në korrespondencë me velkrofin e montuar në xhep.

Dy xhepa anësorë:

Janë të pozicionuar secili prej tyre në linjën anësore në drejtim diagonal, me hapje rreth 6 cm dhe gjatësi rreth 15 cm të montuar në tegelin bashkues të qemerit me pantallonat. Xhepat janë të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh të përforcuar si lart dhe poshtë me tegel përforcues në drejtim horizontal. Në brendësi të xhepave janë montuar trastat (foderim) me astarë me përmasa 28x21 cm.

3. XHEPA KARGO

Në secilën këmbë, në lartësi të linjës së kofshëve janë montuar në gjysmën ndërmjet pjesës përpara dhe pjesës pas një xhep "kargo"me lartësi rreth 22 cm dhe gjerësi rreth 20 cm, të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh në tre drejtimet. Xhepat janë montuar me kulme në pjesët fundore. Bordura e sipërme e xhepit ka lartësi rreth 25 mm dhe është përshkuar me tegel një gjilpërësh. Në dy anët e bordurës janë montuar dy velkrofë" mashkull" me përmasa 2,5x4 cm. Në tegelin anësor nga jashtë këmbës ësht realizuar një palë në xhep.
Secili xhep është i ndarë në tre pjesë vertikale të barazlarguara në distancë rreth 7 cm secila. Palat janë përshkruar me tegel linear një gjilpërësh në drejtim vertikal. Në brendësi të xhepit ndërmjet dy mostrave të xhepit është ndërfutur një xhep tjetër i brendshëm me pikënisje nga pjesa vertikale e parë deri në segmentin e dytë ndarës. Xhepi i brendshëm hapet dhe mbyllet me anë të zinxhirit vertikal në distancë rreth 3,5 cm nga fillimi i segmetit të parë. Zinxhiri ka gjatësi rreth 14 cm në tonalitet me tekstilin e pantallonave dhe është montuar me hedhje të dy mostrave të jashme. Xhepi në brendësi është foderuar me astar rrjetë.
Mbi secilin xhep është montuar kapaku me tekstil dopio të njëjtë me atë të pantallonit, me kulme. Përgjatë drejtimeve të lira kapaku është realizuar me tegel linear dy gjilpërësh. Në brendësi të kapakut janë montuar dy velkrofët "femër" në korrespondencë me velkrofët " mashkull" të montuar në xhepa.

Dy xhepa fileto me kapakë pjesa pas

Janë realizuar me hapje (gjerësi) 14 cm të përfunduara me një fileto të realizuar me të njëjtin tekstil dopio me lartësi 2,5 cm dhe i përforcuar në bordet anësore. Në anët e filetos të xhepit janë montuar dy montuar velkrofët "mashkull" me dimensione 2,5x4 cm.
Mbi xhep është montuar kapaku i xhepit realizuar me të njëjtin tekstil dopio i përshkuar me tegel qepës dy gjilpërësh, rreth 5 mm nga bordet. Baza e kapakut është montuar në trupin e këmbës. Në brendësi të kapakut të xhepit janë montuar velkrofët "femër" (i butë) në korrespondencë me velkrofët e aplikuar në xhep me të njëjtat dimensione.

RRIPI OPERACIONAL MULTIFUNKSIONAL

a. Materialet bazë që do të përdoren për prodhimin e artikullit rripi operacional multifunksional duhet të jenë të cilësisë së parë, të përshtatshme për funksione operacionale, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra:	*E zeza*
Përbërja:	*100% najlon*
Pesha e tekstilit të rripit:	*850-950 D*
Thurja e tekstilit të rripit	*Oxford*
Thurja e tekstilit të aksesorëve të rripit:	*Garniturë*

Rripi duhet të jetë i tipit operacional (tactical) standard, i pajisur me të gjithë aksesorët e nevojshëm për forcat e policisë në detyrë.

Pjesët përbërëse të rripit:

- *Rripi*
- *Tokëza plastike*
- *Ylykët*

AKSESORËT E RRIPIT:

Këllëf për pistoletën

Xhep i dyfishtë me kapak për karikatorët e pistoletës

Unaza metalike për shkopin të gomës ose elektrikun e dorës

Xhep me kapak për gypin e alkoolit

Xhep me kapak për prangat

Xhep me kapak për spraj me lëng lotsjellës

Xhep me kapak për radion

Xhep për teleskopin ose detektorin e metaleve

Mbajtëse çelësash

KAPELE OPERACIONALE (BASEBALL)

Kapele Operacionale

Model Baseball

Kapelja është me strehë dhe është me materialin bazë si të kostumit operacional RIP -STOP .

DOREZA LUFTIMI

Përbërja e materialit :

50 % Lëkure Lope
25 % Naylon
25% Neoprene

Astari :

100 % Armortex

Pjesët përbërëse të dorezës:

- PJESA E KURRIZIT DHE E PËLLËMBËS
- MBYLLJE TE PJESA E KYÇIT ME MANSHETË SHTRËNGUESE
- SHIRITAT MES GISHTAVE
- ASTAR

Dorezat e luftimit duhet të jenë të zeza, prej lëkure dhe me najlon dhe neoprene me pjesë shtesë mes gishtave. Mbyllje te pjesa e kycit me manshetë shtrënguese. Pjesët e qepura nuk duhet të jenë të tërhequra ose me rrudha.

Dorezat duhet të jenë të veshura me astar armotex .

KOSTUM RIP-STOP PËR FORCAT SPECIALE
NGJYRË E ZEZË

	*** Qëndrueshmëria në pastrim kimik ISO 105 DO1**			
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës	4.0			C.I.S 4.0
	*** Qëndrueshmëria në fërkim ISO 105 X12**			
	në të thatë:	në të njomë:		në të thatë: 4-5
	4.0	3.0		në të njomë: 4.0
	*** Stabiliteti dimensional në larje ISO 6330 2A**			
	Baza:	-2.0%		-3.00%
	Indi:	-1.0%		-3.00%
	*** Stabiliteti dimensional I trikotazheve AATCC 179 Opt:1**			
	Ndryshimi	1.4%		2.00%
	*** Qëndrueshmëria në terheqje ISO 13934-2**			
	Qëndrueshmëria e bazës :	78.5 Kg		15 Kg
	Qëndrueshmëria e Indit :	52 Kg		15 Kg
	*** Qëndrueshmëria në grisje ISO 13937-1**			
	Qëndrueshmëria e bazës :	46 N		20 N
	Qëndrueshmëria e Indit :	52 N		20 N
	*** Qëndrueshmëria në grisje e tegelit qepës ISO 13936-1**			
	Tegeli në drejtim të bazës :	Hapi i tegelit: 6 mm		6mm @ 12 kg
	Tegeli në drejtim të indit :	Hapi i tegelit: 6 mm		6mm @ 12 kg
	*** Vonuesit e flakës ISO 11612**			
	Kalon			Initial
	0			
	Kalon			A/50 Larje
	*** Abrazion (Martindale) ISO 12947-2**			9 Kpa @ 20000 Cycles
	Thread not broken			

							STANDARDI
*** Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë ISO 105 BO2**							
Ndryshimi I ngjyrës: 4.0							4.0
*** Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë ISO 105 BO7**							
Ndryshimi I ngjyrës: 4-0							4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
***Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje ISO 105 CO6 E2S**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Viskozë	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në ujë të kloruar ISO 105 N01**							C.I.S 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës			4.0				Njollosja 4.0
*** Qëndrueshmëria në ujë ISO 105 EO1**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në djersë ISO 105 EO4 Acide**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në djersë ISO 105 EO4 Alkaline**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							

*** Qëndrueshmëria ne piling ISO 12945-2 @ 2000 Cycles**	
4.0	4 - 5
*** Masa për njësi të sipërfaqes ASTM-D 3776**	
206.7 g/m2	205 +/-5 g
*** Përmbajtja e Formaldehideve ISO 14184-1**	
40 ppm	< 75 ppm
*** Testi i pH-it ISO 3071**	
7.4	4.5-7.5
*** Përbërja e pëlhurës AATCC-20/A/20**	
PC	PC
***Gjerësia përfundimtare ASTM-D 3774**	
58.5"	58"/59"
*** Zgjatimi ASTM-D 3107**	
11.0%	12-16%
***Zgjatimi plastik ASTM-D 3107**	
2.5%	
*** Zgjatimi elastik ASTM-D 3107**	
76.0%	
*** Depërtueshmeria e ujit ISO 4920**	
100	A/5 Wash 70
*** Depërtueshmeria e vajrave ISO 144194**	
100	A/5 Wash 70

KOSTUM DOKU RIP STOP NGJYRË E ZEZË PËR SHËRBIMIN

PËRSHKRIMI

Eshtë realizuar me tekstil rip stop ngjyrë e zezë dhe përbëhet nga këto elementë:

- 1/XHAKETA
- 2/PANTALLONA

1/XHAKETA

Xhaketa është model monopetë, ngjyrë e zezë dhe përbëhet nga këto elementë:

- Përpara (me prerje në linjën qendrore me dy pjesë)
- Pjesa pas
- Jaka
- Dy mëngë të gjata

1. PËRPARA

Është realizuar me dy pjesë; të bashkuara ndërmjet tyre përgjatë linjës qendrore në drejtim vertikal. Pjesët përpara bashkohen me njëra – tjetrën nëpërmjet një zinxhiri plastik me ngjyrë në tonalitet me tekstilin;Ka një paramonturë e cila mbyllet me velkrof të qepur kryq. Paramontura ka gjerësi rreth 4,5 cm me gjatësi deri në linjën fundore të xhaketës. Po ashtu në brendësi të paramonturës është montuar zinxhiri me ngjyrë të zezë, me gjatësi rreth 55 cm. Zinxhiri është montuar me tegel një gjilpërësh. Bordurat përpara janë montuar me trupin e xhaketës me tegel qepës dy gjilpërësh, ndërsa në anët e lira janë përshkruar me tegel një gjilpërësh. Secila pjesë përpara bashkohet me jakën me tegel një gjilpërësh; ndërsa në linjat e supeve, mëngët dhe linjat anësore nëpërmjet tegelit linear dy gjilpërësh. Linja fundore e xhaketës përfundon me një kthim pale rreth 20 mm lartësi me anë të tegelit një gjilpërësh.

Xhepa të vegjël në linjën e gjoksit

Në linjën e gjoksit janë montuar dy xhepa të pjerrët, me kapakë. Xhepat kanë përmasa: thellësi 13 cm, gjerësi 14 cm. Montimi i kapakëve eshtë realizuar me anë të tegelit linear një gjilpërësh. Kapakët janë montuar me kulme dhe përshkuar në të gjitha drejtimet me tegel një gjilpërësh.

2. PJESA E PASME

Pjesa pas e xhaketës është me prerje përgjatë linjës qendrore dhe përfundon në fund me një kthim pale rreth 2 cm lartësi. Pjesët bashkohen në drejtim vertikal me anë të tegelit dy gjilpërësh. Në secilën anë të pasme në distancë rreth 5,5 cm nga linja e supit është aplikuar një palë e hapur tekstili me gjerësi rreth 4 cm, me vazhdim deri në linjën e belit për lirshmëri më të mirë të xhaketës e përshkuar me tegel dy gjilpërësh dhe e përforcuar në dy bordet.

3. MËNGËT

Xhaketa është e përbërë nga dy mëngë të gjata të modeluara me dy pjesë. Montimi i mëngës realizohet ne tegel të poshtëm dhe tegel anësor dy gjilpërësh në drejtim horizontal. Në pjesen e sipërme të sejcilit krah është i montuar një xhep kargo me kapak me mbyllje me velkrof, si dhe i mbuluar me velkrof për ngjitjen e stemave. Në lartësinë e bërrylave është e qepur një pjesë përforcuese e cila në pjesën e sipërme të saj ka një hapje të ngjitur me velkrof për vendosen e përforcuesve për mbrojtjen e bërrylit. Në parakrahun e majtë ka një xhep me të njëjtin tekstil për vendosjen e stilolapsave.
Mëngët përfundojnë me përthyerje me lartësi rreth 5 cm, ku është vendosur një gjuhës rreth 8 cm e gjatë e cila perfundon me kulm. Kjo gjuhëz është e paisur me velkrof dhe shërben për rregullimin e gjërësisë së fundit të mëngës.

4.JAKA

Jaka e xhaketës është realizuar model korean me tekstil dopio, baza e të cilës montohet me pjesët përpara dhe pjesën pas me anë të tegelit linear një gjilpërësh. Tre drejtimet e lira janë përshkuar me anë të tegelit linear perimetral. Jaka ka lartësi rreth 5,5 cm.

5. SPALETAT

Baza e spaletës në secilën pjesë është montuar në kokën e mëngës. Spaleta ka përmasa: 17 x 5 cm me vazhdimësi përgjatë pjerrësisë së supit. Është realizuar me të njëjtin tekstil si ai i xhaketës. Spaleta është modeluar me kulme në pjesën fundore të saj; është aplikuar vrimë horizontale me hapje 25 mm në korrespondencë me kopsën plastike me ngjyrë blu të montuar në bazamentin e spaletës. Spaleta qëndron e palosur me anë të kalimit të saj në ylykun e montuar në trupin e xhaketës.

AKSESORËT

Shenja Krahu

*a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e POLICISË SË BURGJEVE*

*b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.*

GRADA

*Gradat e supeve janë të vendosura në spaletat e xhaketës dhe janë me dimensione 60 mm*90 mm*58 mm sipas rangut përkatës.*

*c.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit.*

2/PANTALLONA

Pantallonat e dokut janë realizuar me tekstil ngjyrë të zezë dhe përbëhen nga këto elementë:

- Qemeri
- Dy këmbë
- Dy xhepa fileto
- Dy xhepa oblig klasikë të montuar përgjatë linjave anësore
- Dy xhepa kargo
- Dy xhepa drejtkëndorë

1. QEMERI

Është realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 4 cm, i bashkuar me trupin nëpërmjet tegelit qepës një gjilpërësh. Në të majtë të veshur të qemerit është aplikuar një vrimë horizontale me gjerësi rreth 2,5 cm. Në korrespondencë me të në të djathtë të veshur është montuar një buton plastik me ngjyrë të zezë. Gjithashtu në brendësi të qemerit ka një lidhëse pambuku për rregullimin e masës. Në lartësinë e qemerit përgjatë perimetrit janë aplikuar 7 kalues me përmasa: gjerësi rreth 1 cm lartësi rreth 7 cm të pozicionuar përkatësisht;

- *Pesë kalues të montuar në pjesët pas*
- *Dy kalues në pjesën përpara*

Kaluesit janë përshkruar përgjatë qendrës me tegel dy gjilpërësh dhe fiksuar në trupin e pantallonave në bordurat e sipërme dhe të poshtme. Bashkimi bëhet me anë të kopsave të fshehura.

2. KËMBËT

Secila këmbë është realizuar nga dy pjesë, një pjesë e përparme dhe një e pasme, të bashkuara me tegel qepës dy gjilpërësh në drejtim vertikal në linjën anësore nga jashtë këmbës, ndërsa nga brenda këmbës janë bashkuar me tegel një gjilpërësh.
Këmbët e pantallonit përfundojnë me një kthim pale rreth 20 mm lartësi realizuar me tegel një gjilpërësh. Në pjesët përpara nën xhepin kargo në pantallona është realizuar një prerje në formë arne drejtkëndore sipas gjerësisë së pantallonave. Arna ka lartësi rreth 29 cm dhe është përshkuar në anën e sipërme dhe të poshtme me tegel dy gjilpërësh ndërsa anësoret janë montuar në tegelat bashkues të pantallonave.

Dy xhepa anësorë:

Janë të pozicionuar secili prej tyre në linjën anësore në drejtim diagonal, me hapje rreth 6 cm dhe gjatësi rreth 16 cm të montuar në tegelin bashkues të qemerit me pantallonat. Xhepat janë të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh të përforcuar si lart dhe poshtë me tegel përforcues në drejtim horizontal. Në brendësi të xhepave janë montuar trastat (foderim) me astarë me përmasa 28x21 cm.

3. XHEPA KARGO

Në secilën këmbë, në lartësi të linjës së kofshëve janë montuar në gjysmën ndërmjet pjesës përpara dhe pjesës pas një xhep "kargo"me lartësi rreth 22 cm dhe gjerësi rreth 22 cm, të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh në tre drejtimet. Bordura e sipërme e xhepit ka lartësi rreth 25 mm dhe është përshkuar me tegel një gjilpërësh. Në dy anët e bordurës janë montuar dy velkrofë" mashkull" me përmasa 2,5x4 cm. Në tegelin anësor nga jashtë këmbës ësht realizuar një palë në xhep.
Secili xhep është i ndarë në tre pjesë vertikale të barazlarguara në distancë rreth 7 cm secila. Palat janë përshkruar me tegel linear një gjilpërësh në drejtim vertikal.
Mbi secilin xhep është montuar kapaku me tekstil dopio të njëjtë me atë të pantallonit. Përgjatë drejtimeve të lira kapaku është realizuar me tegel linear dy gjilpërësh. Në brendësi të kapakut janë montuar dy velkrofët "femër" në korrespondencë me velkrofët " mashkull" të montuar në xhepa.

Dy xhepa me kapakë pjesa pas:

Janë realizuar me hapje (gjerësi) 14 cm. Në anë të xhepit janë montuar dy kopsa plastike me dimension 20 mm.
Mbi xhep është montuar kapaku i xhepit realizuar me të njëjtin tekstil dopio i përshkuar me tegel qepës dy gjilpërësh, rreth 5 mm nga bordet. Baza e kapakut është montuar në trupin e këmbës. Në brendësi të kapakut të xhepit janë dy prerje në korrespondencë me kopsat e aplikuar në xhep me të njëjtat dimensione.

Xhep drejtkëndor me kapak

Xhepi drejtkëndor është montuar nën xhepin kargo, rreth 11 cm më poshtë. Xhepi drejkëndor ka dimensione 11x13 cm. Në linjën fundore është bashkuar me tegel dy gjilpërësh ndërsa në anësor me tegel një gjilpërësh. Në dy anët e xhepit janë montuar velkrofë 'mashkull" me dimensione 3 cm me 3 cm në korrespondencë me velkrofin "femër" të montuar në kapak, të cilët shërbejnë për hapjen e mbylljen e xhepit me kapakun.

Dy xhepa fileto me kapakë pjesa pas

Janë realizuar me hapje (gjerësi) 14 cm të përfunduara me një fileto të realizuar me të njëjtin tekstil dopio me lartësi 2,5 cm dhe i përforcuar në bordet anësore. Në anët e filetos të xhepit janë montuar dy montuar velkrofët "mashkull" me dimensione 2,5x4 cm.
Mbi xhep është montuar kapaku i xhepit realizuar me të njëjtin tekstil dopio i përshkuar me tegel qepës dy gjilpërësh, rreth 5 mm nga bordet. Baza e kapakut është montuar në trupin e këmbës. Në brendësi të kapakut të xhepit janë montuar velkrofët "femër" (i butë) në korrespondencë me velkrofët e aplikuar në xhep me të njëjtat dimensione.

KOSTUM OPERACIONAL
SPECIAL KUNDRA ZJARRIT





Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja e materialit	**ISO 1833**	70% Fibra Aramid / 30% Viskoze ±3%
Ngjyra		E zezë
Masa	**UNI ISO 12127**	186 g/m² (± 5%)
Thurja	**UNI 8099**	Saia nga 3 fije me efekt RIP STOP (2nr fije per cdo 10 fije ne Vertikal dhe horizontal)
Fije për cm	**ISO 2060**	Vertikal: 60/2 Nm(± 1) Horizontal: 60/2 Nm(± 1)
Zvogëlimi	**UNI EN 1049 -2**	Vertikal: 28 (±1) Horizontal: 25 (±1)
Rezistenca ndaj terheqjes	**ISO 13934**	Vertikal: min. 990 N (-10%) Horizontal: min.860 N (-10%)
Stabiliteti dimensional pas larjes në 60°C	**ISO 6330**	Vertikal: min. 890 N (-10%) Horizontal: min.790 N (-10%)
Qëndrueshmëria në abrazion	**ISO 12947 -2**	100.000 cikle(-10%)
Rezistenca ndaj fërkimit	**ISO 7275**	Vertikal: 198 N (-10%) Horizontal: 198N (-10%)
Stabiliteti dimensional pas larjes në 60°C	**ISO 6330**	Vertikal: min. 129 N (-10%) Horizontal: min.152 N (-10%)
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	**EN ISO 105 B02**	5-6
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 60°C	**ISO 105- C10 prova 3**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	**ISO 105- X12**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	**ISO 105- X12**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj acideve, djersës dhe alkaleve	**ISO 105-E04**	5

PËRSHKRIMI

Është realizuar me tekstil dhe përbëhet nga këto elementë:

- XHAKETA
- PANTALLONA

XHAKETA

Xhaketa përbëhet nga këto elementë:

- **Dy pjesë përpara dhe pjesa prapa**
- **Mëngët**
- **Jaka**
- **Aksesorët**

1. PËRPARA DHE PJESA E PASME

Pjesa përpara është realizuar me dy pjesë të sipërme dhe dy pjesë të poshtme. Bashkimi i pjesëve është i realizuar me qepje tegel dy gjilpërësh. Në pjesën e sipërme të supeve janë të vendosur dy pjesë me dy shtresa nga i njëjti tekstil e cila është e përforcuar me qepje dopio dhe brenda saj vendoset gominë përforcuese e cila fillon nga shpatullat me baze 75 mm deri të jaka e cila është e qepur me tegel një gjilpërësh të dukshëm. Në pjesën përpara është qepur velkro femer me dimensione 12 3 cm dhe në anën tjetër 7 cm *5 cm. Në pjesën përpara janë të qepura dy xhepa në secilën anë. Xhepat janë me zinxhir 18 cm dhe janë të vendosur 1.5 cm poshtë tegelit dy gjilpërësh. Dy pjesët përpara mbyllen me zinxhir 42 cm dhe 6 kopsa të cilat janë të mbuluara me teksil shtesë, bordura është e gjerë rreth 7 cm e qepur me tegel dy gjilpërësh. Kopsat janë të qepura me distance rreth 3 cm nga fillimi i xhaketës. Pjesa e pasme është e përbërë nga dy pjesë; pjesa e sipërme në pjesën e shpinës me gjerësi 12 cm dhe bashkohet me pjesën e poshtme me tegel dy gjilpërësh. Në pjesën e brendshme të këmbëve është qepur më të njëjtin tekstil si të pantallonave një arnë në pjesën përpara dhe prapa të pantallonave.*

2.MËNGËT

*Mëngët janë të gjata dhe në të dy mëngët janë qepur xhepa. Xhepi është 3.5 cm poshtë pjesës së supit. Dimensionet e xhepit jane 18*14 cm me hapje me zinxhir 16 cm. Në pjesën e sipërme të xhepit është qepur velkro 9cm *13 cm. Poshtë xhepit është qepur me tegel dy gjilpërësh dopio tekstil për përforcim me dimensione 18*20 cm (këto dimensione variojnë sipas masës së xhaketës). Në linjën fundore të mëngëve është me dopio tekstil me lartësi 6 cm dhe me fileto dekoruese rreth mëngës. Mbyllja e mëngëve është me gjuhëz me të njëjtin tekstil i qepur me dopio tekstil me tegel dy gjilpërësh me kulme të prera me velkro "mashkull" në pjesën e brendshme që përkon me velkron "femër" të qepur në fundin e mëngës. Dimensionet e gjuhëzës janë 10*6 cm dhe velkro "mashkull" e qepur në mes të gjuhezës në pjesën e brendshme të saj është me dimensione 5*2.5 cm. Dimensionet e velkrof " femer " e qepur në fund të mëngës janë 15 *2.5 cm.*

3.JAKA

*Jaka e xhaketës është realizuar me model klasik me tekstil dopio, baza e së cilës montohet me pjesët përpara dhe pjesën e pasme me anë të tegelit linear një gjilpërësh. Tre drejtimet e lira janë përshkuar me anë të tegelit linear perimetral. Jaka ka lartësi rreth 10 cm. Në jakë është qepur fileto dekoruese. Në kulmet e jakës ka velkro. Poshtë kulmeve të jakës është qepur nga njëra anë gjuhëza me vekro "mashkull" 60*4 cm dhe në anën tjetër velkro "femër" me dimensione 4*2 cm që bën të mundur mbylljen e jakës me model gjysëm jakë (gjysëm golf) .*

4. AKSESORET E XHAKETËS

SHENJA KRAHU

a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e **POLICISË SË BURGJEVE.**

b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.

c.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit.

PANTALLONAT

Pantallonat e dokut janë realizuar me tekstil ngjyrë blu dhe përbëhen nga këto elementë:

- **Qemeri**
- **Dy xhepa klasikë në linjat anësore**
- **Dy këmbë**
- **Dy xhepa kargo**
- **Dy xhepa fileto në pjesën mbrapa**

1. QEMERI

Është realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 4 cm, i bashkuar me trupin nëpërmjet tegelit qepës një gjilpërësh. Në të majtë të veshur të qemerit janë aplikuar dy vrima horizontale me gjerësi rreth 2,5 cm. Në korrespondencë në të djathtë të veshur janë montuar dy kopsa me ngjyrë të zezë. Në lartësinë e qemerit përgjatë perimetrit janë aplikuar 5 ylykë me përmasa: gjerësi rreth 1.5 cm, lartësi rreth 6 cm të pozicionuar përkatësisht;

Tre kalues të montuar në pjesët e pasme

Dy kalues në pjesën përpara

Kaluesit janë përshkruar përgjatë qendrës me tegel dy gjilpërësh dhe fiksuar në trupin e pantallonave në bordurat e sipërme dhe të poshtme.

Në finjën qendrore përpara qemeri zgjatet dhe përfundon me kulme të prera rreth 7 cm. Mbylija e pantallonave bëhet me anë të 3 kopsave të montuara në bordurën e brendëshme që lidhet me qemerin me gjerësi 4 cm dhe lartësi 21 cm e cila korrespondon me bordurën ku janë të hapura vrimat përkatëse. Gjerësia dhe lartësia e bordurës është e njëjtë. Kopsat janë të padukshme, ato mbulohen me një bordurë nga i njëjti tekstil i pantallonave.

2. KËMBËT

Secila këmbë është realizuar nga dy pjesë, një pjesë e përparme dhe një e pasme, të bashkuara me tegel qepës dy gjilpërësh në drejtim vertikal në linjën anësore nga jashtë këmbës, ndërsa nga brenda këmbës janë bashkuar me tegel një gjilpërësh.
Këmbët e pantallonit përfundojnë me një kthim pale rreth 20 mm lartësi realizuar me tegel një gjilpërësh ku në brendësi të saj kalon një llastik në formë kordoni që përfundon me një kaëpse plastike për rregullimin e masës. Në pjesët përpara nën xhepin kargo në pantallona është realizuar një prerje në formë arne drejtkëndore sipas gjerësisë së pantallonave. Arna ka lartësi rreth 29 cm dhe është përshkuar në anën e sipërme dhe të poshtme me tegel dy gjilpërësh ndërsa anësoret janë montuar në tegelat bashkues të pantallonave. Në secilën anë në drejtim horizontal janë aplikuar katër tegela qepës në formë pence me gjatësi rreth 7 cm. Në pjesën e pasme është realizuar një prerje në distancë rreth 5 cm nga bordet e qemerit përgjatë qendrës pas dhe linjat anësore. Pjesët pas në qendër janë montuar me tegel qepës dy gjilpërësh. Në pjesën e këmbëve është qepur fileto me ngjyrë blu nga fundi i xhepit Kargo deri në fund të pantallonave.

Dy xhepa anësorë: *Janë të pozicionuar secili prej tyre në linjën anësore në drejtim diagonal, me hapje rreth 5 cm dhe gjatësi rreth 16 cm të montuar në tegelin bashkues të qemerit me pantallonat. Xhepat janë të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh të përforcuar si lart dhe poshtë me tegel përforcues në drejtim horizontal. Në brendësi të xhepave janë montuar trastat me tekstilin e njëjtë me përmasar reth 31x18 cm.*

Dy xhepa fileto me kapakë pjesa e pasme: *Janë realizuar me hapje (gjerësi) 13 cm të përfunduara me një fileto të realizuar me të njëjtin tekstil dopio me lartësi 1cm dhe i përforcuar në bordet anësore. Distanca e qepjes së kopsave është 3 cm që nga fillimi i filetos. Mbi xhep është montuar kapaku i xhepit i realizuar me të njëjtin tekstil dopio i përshkuar me tegel qepës dy gjilpërësh, rreth 5 mm nga bordet. Baza e kapakut është montuar në trupin e këmbës. Në brendësi të kapakut të xhepit janë vrimat e kopsave në korrespondencë me kopsat e aplikuar në xhep me të njëjtat dimensione.*

Xhepa kargo
Në secilën këmbë, në lartësi të linjës së kofshëve janë montuar në gjysmën ndërmjet pjesës përpara dhe pjesës pas një xhep "kargo"me lartësi rreth 22 cm dhe gjerësi rreth 20 cm, të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh në tre drejtimet. Bordura e sipërme e xhepit ka lartësi rreth 30 mm dhe është përshkuar me tegel një gjilpërësh. Në mes të bordurës janë qepur tre kopsa të zeza. Në tegelin anësor nga jashtë këmbës është realizuar një palë në xhep.
Secili xhep është i ndarë në tre pjesë vertikale të barazlarguara në distancë rreth 7 cm secila. Palat janë përshkruar me tegel linear një gjilpërësh në drejtim vertikal. Në brendësi të xhepit ndërmjet dy mostrave të xhepit janë ndërfutur dy xhepa të tjerë të brendshëm me pikënisje nga pjesa vertikale e parë deri në segmentin e dytë ndarës. Xhepat e brendshëm janë secili me gjerësi 10 cm.
Mbi secilin xhep është montuar kapaku me tekstil dopio të njëjtë me atë të pantallonit. Përgjatë drejtimeve të lira kapaku është realizuar me tegel linear dy gjilpërësh. Në brendësi të kapakut janë hapur tre vrima qe perkojne me vendosejen e kopsave,

KOMINOSHE OPERACIONEALE



	*** Qëndrueshmëria në pastrim kimik ISO 105 DO1**			
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës	4.0			C.I.S 4.0
	*** Qëndrueshmëria në fërkim ISO 105 X12**			
	në të thatë:	në të njomë:		në të thatë: 4-5
	4.0	3.0		në të njomë: 4.0
	*** Stabiliteti dimensional në larje ISO 6330 2A**			
	Baza:	-2.0%		-3.00%
	Indi:	**-1.0%**		-3.00%
	*** Stabiliteti dimensional I trikotazheve AATCC 179 Opt:1**			
	Ndryshimi	**1.4%**		2.00%
	*** Qëndrueshmëria në terheqje ISO 13934-2**			
	Qëndrueshmëria e bazës :	78.5 Kg		15 Kg
	Qëndrueshmëria e Indit :	52 Kg		15 Kg
	*** Qëndrueshmëria në grisje ISO 13937-1**			
	Qëndrueshmëria e bazës :	46 N		20 N
	Qëndrueshmëria e Indit :	52 N		20 N
	*** Qëndrueshmëria në grisje e tegelit qepës ISO 13936-1**			
	Tegeli në drejtim të bazës :	Hapi i tegelit: 6 mm		6mm @ 12 kg
	Tegeli në drejtim të indit :	Hapi i tegelit: 6 mm		6mm @ 12 kg
	*** Vonuesit e flakës ISO 11612**			
	Kalon			Initial
	0			
	Kalon			A/50 Larje
	*** Abrazion (Martindale) ISO 12947-2**			9 Kpa @ 20000 Cycles
	Thread not broken			

65% polyester 35 % pambuk							***STANDARDI***
*** Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë ISO 105 BO2**							
Ndryshimi I ngjyrës: 4.0							4.0
*** Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë ISO 105 BO7**							
Ndryshimi I ngjyrës: 4-0							4-5
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
***Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje ISO 105 CO6 E2S**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Viskozë	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në ujë të kloruar ISO 105 N01**							C.I.S 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës			4.0				Njollosja 4.0
*** Qëndrueshmëria në ujë ISO 105 EO1**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në djersë ISO 105 EO4 Acide**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							
*** Qëndrueshmëria në djersë ISO 105 EO4 Alkaline**							
C.I.S	Njollosja						
	Acetat	Pambuk	Nailon	Poliester	Akrilik	Lesh	C.I.S 4.0
4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	Njollosja 4.0
C.I.S = Ndryshimi I ngjyrës							

*** Qëndrueshmëria ne piling ISO 12945-2 @ 2000 Cycles**	
4.0	4 - 5
*** Masa për njësi të sipërfaqes ASTM-D 3776**	
206.7 g/m2	205 +/-5 g
*** Përmbajtja e Formaldehideve ISO 14184-1**	
40 ppm	< 75 ppm
*** Testi i pH-it ISO 3071**	
7.4	4.5-7.5
*** Përbërja e pëlhurës AATCC-20/A/20**	
PC	PC
***Gjerësia përfundimtare ASTM-D 3774**	
58.5"	58"/59"
*** Zgjatimi ASTM-D 3107**	
11.0%	12-16%
***Zgjatimi plastik ASTM-D 3107**	
2.5%	
*** Zgjatimi elastik ASTM-D 3107**	
76.0%	
*** Depërtueshmeria e ujit ISO 4920**	
100	A/5 Wash 70
*** Depërtueshmeria e vajrave ISO 144194**	
100	A/5 Wash 70

DIZAJNI

PJESA E PËRPARME

Kominoshja operacionale është përshtatshme për periudhë të verës dhe vjeshtës. Mbyllja përpara me zinxhirë dysh që të mbulojë të gjithë gjatësinë e kominoshes.Ne pjesën e gjoksit janë te qepura dy xhepa te pjeret te cilat mbyllen me zinxhir me gjatesi 19cm thellesi 26cm.

Në pjesën e këmbeve ka te njejtat xhepa anesore ne secilën këmbë me të njëjtat me zinxhir me gjatesi 19cm thellesi 26cm.

Në pjesën e shpatullave, të supeve, të brrylave dhe të gjunjëve ka të përforcuar një shtresë dyshe me vatinëMe tegel te dukshem ne forme rrombi.

JAKA

Jaka ka lartësi 7cm dhe mbyllet me velkrof "femër mashkull"

PJESA E PASME

Një pjesën e belit ka llastik për të siguruar lëvizshmërinë. Në pjesën e vitheve ka një zixhir të harkuar. Dhe me dopio tekstil.

MËNGËT

*Janë të përbëra nga dy pjesë me prerje të drejtë dhe në fundin e tyre janë të vendosura man-sheta me dimensione 11*7*6.5cm që përfundon me një kulm kuposhte saj është qepur velkrof femër qe përkon me velkrof mashkull qepur ne mëngë, e cila shërben për rregullimin e masës.Në anën e majte të veshur është qepur një xhep drejtkendor me zinxhir 17cm me thellesi 12 cm .ne pjesen e sipërme të xhepit ka të qepur xhep për mbajtjen e stilolapsave .*

SPALETAT

*Në pjsën e supeve në secila anë është e qepur spaleta me të njëjtin tekstil e cila përfundon me kulm dhe mbylet me kopsë me dimensione 14*4.5*

AKSESORËT

Shenja Krahu

*a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e POLICISE SE BURGJEVE*

*b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.*

GRADA

*Gradat e supeve janë të vendosura në spaletat e xhaketës dhe janë me dimensione 60 mm*90 mm*58 mm sipas rangut përkatës.*

BLUZË ME MËNGË TË GJATA TERMIKE

PER POLICINE E BURGJEVE BLU E ERRET
PER FORCAT SPECIALE E ZEZE



MATERIALI BAZË

Skeda Teknike

Nr.	METODA	SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TRIKOTAZHIN KRYESOR TË BLUZËS ME MËNGË TË GJATA	
1	ISO 3801:2013	Përcaktimi i Masës	180 g/m2± 5%
2	ISO 7211/1:1984	Përcaktimi i Ilojit të thurjes	Trikotazh Indi
3	ISO 1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	70% CO 30% PES
4	ISO 105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit ndaj larjes në 40°C	NOTA 4-5
5		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	

PËRSHKRIMI

Bluza është modeluar me jakë të rrumbullakët dhe përbëhet nga:

- JAKA
- PJESA PËRPARA
- PJESA E PASME
- MËNGË TË GJATA NË FORMË TUBOLARE

Jaka është realizuar me trikotazh me ngjyrë të zezë, e modeluar me formë të rrumbullakët me bordurë të përfunduar rreth 2 cm. Jaka është montuar me trupin me anë të tegelit dy gjilpërësh dhe e pastruar me syzator në brendësi. Në secilën pjesë është me pikënisje nga pjesa anësore e jakës dhe vazhdimësi në gavaturën e mëngës është realizuar prerje. Gjithashtu në anësor, në distancë rreth 15 cm nga pika e nënsqetullës (gavaturë) është realizuar një tjetër ndërfutje trikotazhi e njëjtë me atë të bluzës me vazhdimësi në pjesën e poshtme të mëngës në formë gjysmëhëne. Pjesët e bluzës bashkohen në linjën anësore, prerjen e pjesëve në gavaturë (rreth mënge) me anë të tegelit zbulurues nga jashtë ndërsa në brendësi me syzator pesëfijësh. Linja fundore e bluzës si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën e pasme përfundon me një kthim pale me lartësi rreth 20 mm të realizuar me tegel linear dygjilpërësh. Mëngët janë të gjata të realizuara me trikotazh dhe bashkuar me tegel zbukurues dhe syzator në brendësi. Në pjesën fundore secila mëngë përfundon me bordurë trikotazhi e montuar me syzator pesëfijësh. Bluza eshte termike.

BLUZË ME MËNGË TË SHKURTA POLO

PER POLICINE E BURGJEVE BLU E ERRET
PER FORCAT SPECIALE E ZEZE

MATERIALI BAZE

Skeda Teknike

Nr.	METODA	SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TRIKOTAZHIN E BLUZËS POLO ME MËNGË TË SHKURTRA	
1	ISO 3801:2013	Përcaktimi i Masës	260 g/m2± 5%
2	ISO 7211/1:1984	Përcaktimi i Ilojit të thurjes	Syth Irlandez
3	ISO 1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	50% CO 50%PES
4	ISO 105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit ndaj larjes në 40ºC	NOTA 4-5
5		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TEKSTILIN RRJETË TË NDËRFUTUR NË ANËSORE

PËRBËRJA

: 100% POLIESTËR

BLUZË ME MËNGË TË SHKURTA

Bluza Polo me mëngë të shkurtra është e realizuar me trikotazh me ngjyrë të zezë sipas përshkrimeve dhe përbëhet nga këto elementë:

- JAKA
- PËRPARA
- PJESA E PASME
- DY MËNGË TË SHKURTRA

1.JAKA

Jaka është model klasik, e realizuar me trikotazh me ngjyrë të zezë, thurje llastik në drejtim vertikal me lartësi standarde rreth 8 cm dhe bashkohet me pjesët përpara dhe pas të bluzës me anë të një filetoje me gjerësi rreth 10 mm. Fileto montohet në jakë me tegel dy gjilpërësh përgjatë gjithë gjatësisë së saj. Jaka është montuar me tegel linear një gjilpërësh.

2.PËRPARA

Përpara bluza Polo është modeluar me jakë klasike punim trikotazh. Përgjatë linjës qëndrore në afërsi të jakës është aplikuar një hapje me thellësi rreth 17 cm dhe gjerësi rreth 4 cm. Në anën e majtë të veshur në hapje (të quajtur dhe fileto) janë aplikuar tre vrima, një vrimë në drejtim horizontal në distancë rreth 1,5 cm nga bordura e sipërme dhe dy të tjerat në drejtim vertikal në distancë rreth 4 cm nga vrima e parë.
Ana e djathtë përbëhet nga dy shtresa tekstili me ngjyrë të zezë, të montuara me tegel një gjilpërësh dhe në fund të hapjes është montuar një ylyk dopio me lartësi rreth 1,5 cm dhe gjerësi të njëjtë me atë të hapjes. Në linjën qendrore përgjatë aksit të kësaj bordure janë montuar tre kopsa plastike me ngjyrë të zezë. Kopsat janë montuar me qepje kryq.
Në distancë rreth 9 cm nga koka e mëngës dhe 5,5 nga pika e qafës është realizuar një prerje dhe montim i mostrës në formë trapezoidale me vazhdimësi me pjesën pas. Në gavaturë në distancë rreth 17 cm është montuar një tekstil rrjetë në formë gjysmëhëne traspirante e cila vazhdon dhe përgjatë pjesës së poshtme të mëngëve. Çdo pjesë është bashkuar me tegel tre gjilpërësh. Në anësore pjesët bashkohen me anë të syzatorit pesëfijësh.
Në dy anët fundore në anësore janë aplikuar dy çarje me hapje me gjatësi 4 cm të përforcuara nga brenda me fileto rreth 1 cm gjerësi e njëjtë me tekstilin. Linja fundore përfundon me një kthim pale rreth 2 cm e realizuar me tegel zbukurues tre gjilpërësh e përforcuar nga brenda me tegel syzator.

3. PJESA E PASME

Eshtë realizuar pa prerje në linjën qendrore. Bashkimi i pjesës së pasme me supet realizohet me tegel tre gjilpërësh. Në secilën mëngë në gavaturë është montuar ndërfutje tekstili rrjetë traspirante në formë gjysmëhëne me vazhdimësi dhe në pjesët e poshtme të mëngëve. Linjat anësore përfundojnë me dy çarjet anash të aplikuara si në pjesën përpara. Linja fundore përfundon me një kthim pale rreth 2 cm e realizuar me tegel zbukurues tre gjilpërësh e përforcuar nga brenda me tegel syzator.

4. MËNGË TË SHKURTRA

Mëngët janë realizuar me trikotazh me thurje syth irlandez, ngjyrë të zezë, në formë tubolare me dy pjesë. Në pjesën e sipërme mëngët janë realizuar me trikotazh me ngjyrë të zezë të njëjtë me tekstilin e bluzës. Në secilën mëngë në pjesën e poshtme me fillim nga gavatura dhe vazhdimësi deri në fund të mëngës është montuar tekstili rrjetë traspirante në formë drejtkëndore përfunduar me kulme. Tekstili rrjetë bashkohet me pjesën tjetër të mëngës me anë të tegelit qepës tre gjilpërësh.
Mëngët përfundojnë me një bordurë prej tekstili trikotazh llastik me gjerësi rreth 3 cm. Në distancë rreth 2,5 cm nga koka e mëngës është montuar ndërfutje xhepi i mbyllur. Xhepi në brendësi është ndërtuar me të njëjtin trikotazh me dimensione 18x 15,5 cm. Hapja dhe mbyllja e xhepit realizohet me anë të zinxhirit me ngjyrë të zezë, të montuar në drejtim vertikal me gjatësi rreth 12 cm. Xhepi është përshkuar me tegel zbukurues sipas formës drejtkëndore me kulme të harkuara e cila është. Mbi formën e xhepit në secilën mëngë është montuar velkrof drejtkëndor me kulme të harkuara me përmasa 13 x 7,5 cm.

AKSESORËT E BLUZËS

SHENJA KRAHU

a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e **POLICISE SE BURGJEVE.**

b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.

T- SHIRT ME MËNGË TË SHKURTA

PËR POLICINË E BURGJEVE BLU E ERRËT
PËR FORCAT SPECIALE E ZEZË



MATERIALI BAZË

Skeda Teknike

Nr.	METODA	SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TRIKOTAZHIN KRYESOR T-SHIRT ME MËNGË TË SHKURTRA	
1	ISO 3801:2013	Përcaktimi i Masës	230 g/m2± 5%
2	ISO 7211/1:1984	Përcaktimi i Ilojit të thurjes	Jersey i Thjeshtë
3	ISO 1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	80% Poliestër 20 % Pambuk
4	ISO 105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit ndaj larjes në 40°C	NOTA 4-5
5		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	

PËRSHKRIMI

T-shirt është modeluar me jakë të rrumbullakët dhe përbëhet nga:

- JAKA
- PJESA PËRPARA
- PJESA E PASME
- MËNGË TË SHKURTRA NË FORMË TURBOLARE
- DY XHEPA TË MBYLLUR TË MONTUAR NË SECILËN MËNGË

Jaka është realizuar me trikotazh ngjyrë blu, punim llastik, e modeluar me formë të rrumbullakët me lartësi rreth 2,5 cm. Jaka është montuar me trupin me anë të tegelit dy gjilpërësh dhe e pastruar me syzator në brendësi. Pjesët e T - shirt bashkohen në linjën anësore, linjën e supit dhe në gavaturë (rreth mënge) me anë të tegelit syzator pesëfijësh. Linja fundore e t-shirt si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën e pasme përfundon me një kthim pale me lartësi rreth 20 mm të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh. Mëngët janë të shkurtra të realizuara me trikotazh dhe në pjesën fundore të tyre përfundojnë me kthim pale me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh. Në secilën mëngë është montuar një xhep i mbyllur me të njëtin trikotazh si tek T - shirt. Xhepi është në formë drejtkëndor me përmasa 17x15 cm dhe është montuar me tegel linear një gjilpërësh. Hapja dhe mbyllja e xhepit realizohet me anë të zinxhirit të montuar në drejtim vertikal. Zinxhiri ka gjatësi rreth 14 cm në tonalitet me trikotazhin e artikullit dhe është montuar me tegel një gjilpërësh.

AKSESORËT

SHENJA KRAHU

a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e POLICISE SE BURGJEVE.

b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.

PULOVËR ME JAKË GOLF DHE MËNGË TË GJATA PËR MESHKUJ



PËLHURA

Materiali kryesor

Nr.	METODA	SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TRIKOTAZHIN KRYESOR TË PULOVRËS ME MËNGË TË GJATA, NGJYRË BLU PËR MESHKUJ	
1	ISO 3801:2013	Përcaktimi i Masës	420 g/m2± 5%
2	ISO 7211/1:1984	Përcaktimi i Ilojit të thurjes	Jersey i Thjeshtë
3	ISO 1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	70% PAN 30% WO
4	ISO 105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit ndaj larjes në 40°C	Nota 4
5		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	

DIZAJNI

Pulovra ngjyrë blu është realizuar me anë të makinës së trikotazhit, e modeluar me jakë golf dhe përbëhet nga këto elementë:

- PJESA E PËRPARME
- PJESA E PASME
- JAKA GOLF
- DY MËNGË TË GJATA

Pulovra është realizuar me një pjesë të vetme pa ndërprerje me punim trikotazh thurje interlog dhe në linjën fundore përfundon me një bordurë me lartësi rreth 6,5 cm e cila është realizuar me punim trikotazh thurje llastik 1/1. Ky lloj punimi bën të mundur që bordura fundore e pulovrës të përshtatet me formën trupore në mënyrë që të evitohet zgjerimi dhe deformimi i pulovrës. Jaka është realizuar me punim trikotazh llastik dhe paraqet lartësi rreth 8 cm e përthyer sipas perimetrit të qafës. Mëngët janë në formë tubolare me një pjesë dhe përfundojnë me një bordurë trikotazhi thurje llastik me lartësi rreth 7 cm.

AKSESORËT

a.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit

b.) Në krahun e majtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset grada e gjoksit sipas rangut por-katës.

VESHJE E BRENDSHME BLUZË DHE TUTË ME NGJYRË TË ZEZË

1. JAKA

Jaka është realizuar me trikotazh me ngjyrë të zezë, model gjysëm golf. Jaka ka lartësi rreth 6,5 cm dhe bashkohet me trupin me tegel trefijësh. Në lartësinë e jakës dhe me vazhdim deri në linjën e kraharorit është montuar një zinxhir i zi me gjatësi rreth 34 cm. Zinxhiri shërben për hapjen dhe mbylljen e jakës. Bordura e sipërme e jakës dhe zinxhiri janë montuar me anë të tegelit linear njëfijësh.

2. PJESËT E BLUZËS (PJESA E PËRPARME, PJESA E PASME, MËNGËT)

Përpara dhe pas bluza është realizuar pa prerje. Dy pjesët bashkohen në anësor dhe linjën e supit me anë të tegelit zbukurues. Linja fundore e pjesëve përfundon me një kthim pale me lartësi rreth 20 mm realizuar me tegel dekorativ.
Mëngët janë realizuar me një pjesë dhe montohen me në pjesën e poshtme të tyre dhe me trupin e bluzës në gavaturë me tegel dekorativ. Në secilën mëngë në distancë rreth 2 cm nga bordura e mëngës është realizuar një hapje me gjatësi reth 7 cm e përthyer me anë të tegelit dekorativ. Linja fundore e mëngëve përfundon me një kthim pale me lartësi rreth 20 mm.

1/B. TUTA

1/B. TUTA PËR MESHKUJ ME NGJYRË TË ZEZË

Tutat për meshkuj janë realizuar me të njëjtin tekstil trikotazh si bluza dhe përbëhen nga këto elementë:

- Qemeri
- Dy këmbë

1.QEMERI

Është realizuar me katër pjesë të bashkuara në linjën qendrore të pjesës përpara dhe të pjesës së pasme si dhe në linjat anësore me syzator pesë fijësh me lartësi rreth3 cm. Në brendësi të qemerit është aplikuar llastik për përshtatje të formës trupore. Qemeri bashkohet me trupin e tutave me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh.

2.KËMBËT

Këmbët e tutave janë model i drejtë dhe bashkohen ndërmjet tyre përgjatë linjave qendrore para dhe në pjesën e pasme me anë të tegelit zbukurues. Në linjën anësore dhe brenda këmbëve janë montuar me syzator pesë fijësh. Linja fundore e këmbëve përfundon me kthim pale me lartësi rreth 20 mm të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh.

VESHJE E BRENDSHME BLUZË DHE TUTË ME NGJYRË TË ZEZË

MATERIALI BAZE

Skeda Teknike

Nr.	METODA	SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TRIKOTAZHIN KRYESOR TË KOSTUMIT SPORTIV (BLUZË DHE TUTË) ME NGJYRË TË ZEZË PËR MESHKUJ	
1	ISO 3801:2013	Përcaktimi i Masës	180 g/m2± 5%
2	ISO 7211/1:1984	Përcaktimi i Ilojit të thurjes	Trikotazh Indi me push nga brenda
3	ISO 1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	100% PES
4	ISO 105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit ndaj larjes në 40°C	NOTA 4
5		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	

PËRSHKRIMI

Veshja e brendshme është realizuar me tekstil trikotazh me ngjyrë të zezë dhe përbëhet nga:

- 1/A. BLUZA

1/A. BLUZA

Bluza është e ndërtuar nga këto elementë:

- Jaka
- Pjesa përpara
- Pjesa e pasme
- Mëngë të gjata në formë tubolare

XHUP DIMRI ME TRE SHTRESA

PËR POLICINË E BURGJEVE BLU E ERRËT
PËR FORCAT SPECIALE E ZEZË

Veshja e brendshme e xhupit
të dimrit



SPECIFIKIMET MATERIALI BAZË

Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja e materialit të jashtëm	**ISO 1833**	100 % Poliamid
Ngjyra		Blu e errët
Masa	**UNI ISO 12127**	≥ 97 ≤ 115 g/m²
Thurja	**UNI 8099**	Saia nga 3 fije
Zvogëlimi në cm	**UNI EN 1049 -2**	Vertikal: ≥ 43 ≤ 51 Horizontal: ≥ 29 ≤ 37
Shtresa Funksionale		
Kompozicioni		Membrane PTFE
Përbërja e materialit laminat		
Masa	**UNI ISO 12127**	≥ 145≤ 170g/m²
Rezistenca ndaj ujit	**UNI EN ISO 31092**	Ret ≤ 11m² Pa/W
Rezistenca ndaj terheqjes	**ISO 13934**	Vertikal: 600 N Horizontal: 600N
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	**EN ISO 105 B02**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	**ISO 105- C10 prova 3**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	**ISO 105- X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	**ISO 105- X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj acideve, djersës dhe alkaleve	**ISO 105-E04**	5

PËRSHKRIMI

Xhupi i Dimrit përbëhet nga këto elementë:

- PËRPARA (E KONSTRUKTUAR ME KATËR PJESË)
- XHEPAT
- PJESA E PASME
- DY MËNGË
- KAPUÇ
- JAKA
- PJESA E BRENDSHME (E LËVIZSHME)

1. PËRPARA

Xhupi përpara është realizuar me prerje në drejtim vertikal. Në të djathtë të veshur përgjatë linjës vertikale është montuar një bordurë me kulmet e jashtme të harkuara, me gjerësi rreth 7 cm dhe gjatësi rreth 70 cm. Bashkimi i pjesëve realizohet me anë të me gjatësi rreth 75 cm, të montuar në linjat qendrore përpara dhe me anë të 7 butonave metalike. Në bordurë në linjë me xhepat e montuar në kraharor është montuar një gjuhëz në formë drejtkëndore me kulme me majë. Gjuhëza ka gjatësi rreth 11.5 cm dhe gjerësi 3.5cm. Në distancë rreth 1 cm nga skaji i gjuhëzës është aplikuar buton metalik i fshehur për fiksimin e gjuhëzës me trupin e xhupit. Në secilën pjesë përpara me pikënisje nga linja e supeve deri në linjën e belit është montuar një arnë me tekstil të njëtë, me anë të tegelit dy gjilpërësh në tre drejtimet, ndërsa në linjën qendrore është ndërfutur në tegelin montues të zinxhirit. Në anësor pjesët bashkohen me tegel një gjilpërësh. Linja fundore e secilës pjesë përfundon me kthimin e palës me lartësi rreth 2 cm, ku skajet janë të hapura. Në to është kaluar llastik në formë kordoni i cili përfundon me fiksues plastik për rregullimin e perimetrit.

2. PJESA E PASME

Xhupi në pjesën e pasme është realizuar me një pjesë të vetme

3.MËNGËT

*Janë modeluar me dy pjesë të cilat bashkohen në tegelin anësor me tegel dy gjilpërësh, ndërsa në pjesën e poshtme vazhdojnë me gavaturë të gjerë dhe montohen në tegelin anësor në bel. Në pjesën e poshtme mëngët montohen me tegel linear një gjilpërësh deri në distancë rreth 36 cm. Në këtë linjë është realizuar një hapje e cila qëndron e mbyllur me anë të zinxhirit të brendshëm të montuar në të të cilit i është vendosur një mostër e njëjtë me tekstilin e xhupit, realizuar me tegel një gjilpërësh. Hapja ka gjatësi rreth 34 cm. Në mëngën e majtë tek ana e veshur është qepur një xhep katror me kapak të drejtë. Xhepi ka dimesione 17x17 cm, hapja dhe mbyllja e xhepit kryhet me anë të velkrofëve të aplikuar në brendësi të xhepit.Ne linjën fundore të mëngës është qepur manshetë me tekstilin bazë nga njëra anë me dimensione 12*4 cm dhe nga ana e brendshme me velkrof "mashkull "me dimensione 3.5 *5 cm. Në pjesën e mëngës është qepur velkrofi femër me dimensione 15*4 cm që shërben për rregullimin e masës së mëngës*

a) Xhepat në pjesën e gjoksit *: Janë në formë katrore me dimensione 14*14 cm të mbuluara me kapakë të cilët përfundojnë me kulme me majë. Mbyllja e xhepave bëhet me buton metalik i cili është i vendosur në kulmin e kapakut të xhepave dhe është i fshehur. Gjatësia e kapakut është 14 cm me lartësi 4.5 cm ne pjesen anësore dhe në kulmin e saj 6 cm. Në pjesën e sipërme të kapakut është qepur fileto.*

b) Xhepat në pjesën e belit *: Janë në formë katrore me dimensione 17*17 cm të mbuluara me kapakë të cilët përfundojnë me kulme me majë. Mbyllja e xhepave bëhet me buton metalik i cili është i vendosur në kulmin e kapakut të xhepave dhe është i fshehur. Gjatësia e kapakut është 17 cm me lartësi 5 cm në pjesën anësore dhe në kulmin e saj 6.5 cm. Në pjesën e sipërme të kapakut është qepur fileto.*

4.KAPUÇI

*Është realizuar me të njëjtin tekstil si ai xhupit. Është i përbërë nga tre pjesë të qepura me njëra tjetrën. Në pjesën qëndrore të kapucit është qepur një shirit i qepur në dysh që është montuar një pjesë metalike që lidhet me shiritin tjetër për rregullimin e masës së kapucit. Me tekstilin e vet është qepur një strehë e vogël me hark me dimensione 34*8 cm. Kapuci lidhet me pjesën e jakës me zinxhir të fshehur 35 cm dhe me 4 velkrof femër mashkull me dimension 5*2.5 cm. Në pjesën e brendshme është një llastik i fshehur që përfundon me kapsëe plastike që rregullojnë masën e kapucit. Mbyllja e kapucit bëhet me velkrof "femër mashkull".*

5.JAKA

*Në pjesën e jakës është një kapuc i fshehur. Jaka ka lartësi 12 cm me mbyllje me 4 velkrof "femër mashkull" me dimensione 5*2.5 cm. Kapuci është i përbërë me 4 pjesë të qepura me njëra tjetrën. Në pjesën e brendëshme është nje llastik i fshehur që përfundon me kapëse plastike që rregullojnë masën e kapucit.*

6.PJESA E BRENDSHME

Në pjesën e brendshme është montuar një veshje e ngrohtë e lëvizshme.

Veshja e ngrohtë *është e përbëre nga pjesa përpara e cila është me dy pjesë që mbyllen me zinxhir. Në pjesën e belit ka dy xhepa me zinxhir të qepura vertikal me dimension 18 cm me thellësi 14 cm. Jaka është e lartë 8.5 cm. Në pjesën e gjoksit janë qepur velkrof "femër" në krahun e djathtë të veshur me dimensione 11*3 cm dhe në krahun e majtë të veshur dy velkrof "femër" me dimensione 11*3 cm dhe tjetra 5*6.5 cm me dy mëngë të gjata. Në secilën mëngë duke filluar nga supi 9 cm distancë është e vendosur velkrof "femër" me dimensione 5*3.5 cm në sëcilen mëngë. Këto velkrof shërbejnë për vendosjen e shenjave dhe gradave përkatëse. Kjo veshje e ngrohtë mund të vishet pa xhupin. Fundet e mëngëve janë me llastik dhe një ylyk në pjesën e brendshme të fundit të mëngëve. Linja fundore e secilës pjesë përfundon me kthimin e palës me lartësi rreth 2 cm, ku skajet janë të hapura. Në to është kaluar llastik në formë kordoni i cili përfundon me fiksues plastik për rregullimin e perimetrit. Pjesa e brendshme e veshjes së ngrohtë është me astar nga pjesa e supeve deri në bel dhe në pjesën e brendshme të mengëve.*
Veshja e ngrohtë fiksohet me anë të një shiriti me butona metalike që janë të qepura në pjesën e brendëshme të xhupit në pjesën e brendshme të mëngëve dhe një në pjesën e shpinës. Këto shirita me butona metalike fiksohen në ylykët e qepur nëë pjesën e mëngëve të veshjes së brendshme dhe një ylyk në pjesën e shpinës. Pjesa përpara fiksohet me zinxhir rreth 67 cm. Pjesa e brendshme të xhupit është e veshur me astar. Eshtë mbi vendosur një astar shtesë me gjerësi 22.5 cm e qepur në të gjithë xhupin dhe në fund të astarit shtesë është qepur llastik dhe mbyllja bëhet me butona metalike dhe plastike. Kjo shërben për mos depërtimin e erës. Në fillim të qepjës së astarit shtesë kalon një llastik në formën e kordonit që rregullon masën e belit.

AKSESORËT

!

SHENJA KRAHU

a.) Në krahun e djathtë të veshur është qepur velkrof "femër" në formë rreth me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset Logo e POLICISE SE BURGJEVE.

b.) Në krahun e majtë të veshur është qepur velkrof "femër" me dimensione 80 mm*70 mm ku vendoset shenja sipas funksionit përkatës.

c.) Në krahun e djathtë të veshur në pjesën e gjoksit është qepur velkrof "femër" me dimensione 86 mm*30 mm ku vendoset shenja e identifikimit.

PANTALLONA PËR DIMËR / VERË ME TRE SHTRESA

PËR POLICINË E BURGJEVE BLU E ERRËT
PËR FORCAT SPECIALE E ZEZË

Me veshje të brendshme



Veshja e ngrohtë e brendshme



Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja e materialit të jashtëm	**ISO 833**	100% Poliamid
Ngjyra		E Zezë
Masa	**UNI ISO 12127**	≥ 97 ≤ 115 g/m²
Thurja	**UNI 8099**	Saia nga 3 fije
Zvogëlimi	**UNI EN 1049 -2**	Vertikal: ≥ 43 ≤ 51 Horizontal: ≥ 29 ≤ 37
Shtresa Funksionale		
Kompozicioni		Membrane PTFE
Përbërja e materialit laminat		
Masa	**UNI ISO 12127**	≥ 145≤ 170g/m²
Rezistenca ndaj ujit	**UNI EN ISO 11092**	Ret ≤11 m² Pa/W
Rezistenca ndaj tërheqjes	**ISO 13934**	Vertikal:600 N Horizontal:600N

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	**EN ISO 105 B02**	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	**ISO 105-C010 prova 3**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	**ISO 105-X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	**ISO 105-X12**	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj acideve, djersës dhe alkaleve	**ISO 105-E04**	5

Pantallonat e janë realizuar me tekstil ngjyrë e zezë dhe përbëhen nga këto elementë:

- *Pjesa përpara*
- *Pjesa mbrapa*
- *Veshja e brendshme*

1. Pjesa përpara

Secila këmbë është realizuar nga dy pjesë, një pjesë e përparme dhe një e pasme, të bashkuara me tegel qepës një gjilpërësh në drejtim vertikal në linjën anësore nga jashtë këmbës dhe brenda këmbës .
Këmbët e pantallonit përfundojnë me një kthim rreth 1 cm , ne fund te pantallonave eshte i qepur me te njejtin tekstil gjuheza me velkrof " femër" me dimensione 12*4.5cm e cila fiksohet me velkrof "mashkull" per te rregulluar masën. Ne pjesën anash këmbëve ka zinxhir me gjatësi 35cm.Në pjesët përpara ka dy xhepa anësorë te pjeret me kapak 20*6cm me dopjo tekstil me tegel anësor një gjilpërësh me mbyllje me buton metakik te fshehur. Ne pjesën e gjunjëve ka nje arna me dojo tekstil me 33*30cm e qepur me tegel një gjilpërësh.Mbyllja e pantalonave bëhet me zinxhir me gjatësi 22cm.Ne pjesën e belit është i montuar një llastik në formë kordoni për të rregulluar masën.

2. Pjesa mbrapa

Pjesa mbrapa është e përbërë nga dy pjese pjesa e parë nga beli deri në pjesën e vitheve e cila është qepur dojo tekstil dhe pjesa tjeter deri ne fund te këmbeve te dyja pjesët janë të qepura me tegel një gjilperësh.

3.Veshja e brendshme

Pjesa e brendshme është e realizuar me veshje të ngrohtë të lëvizëshme e cila fiksohet.Ne pjesën fundore me buton metalik ngjyrë te zezë. Veshja është e ngrhotë për sitinën e dimrit .

KËPUCE ME QAFA

Këpucë dimri me qafa

Këto këpucë mbrojnë këmbët gjate periudhës se dimrit pasi janë të ndërtuara me material lëkurë të përpunuar kundër ujit, vajrave, agjentëve kimik dhe lëkurë reflektuese ndaj diellit për të ruajtur nxehtësinë e këmbëve. Pjesa e sipërme e këpucës ka vrima për të siguruar futjen e ajrit për të mbajtur të pastër këmbën.

Pjesa poshtë e këpucës është me material gome të shkrirë për të siguruar jetëgjatësinë e këpucës.

Eshtë e ndërtuar me sistemin hark për të ruajtur qëndrimin natyrore të këmbës në levizje dinamike.

Trashësia e lëkurës: 1,8 – 2,0 cm

Me mbrojtëse për gishtat (me peshë të lehtë)

Tre shtresa materiali GORE-TEX

Certifikuar sipas: CE EN ISO 20345:2011 ;

Klasa e sigurisë: S3

SHOLLA

- E formuar me injeksion direkt: siguron qëndrueshmeri dhe rezistencë
- Shtresa e mesme: poliuteran, siguron mbrojtje dhe komfort si dhe fleksibilitet, peshë më të lehtë dhe izolim ndaj nxehtësisë
- Pjesa e sipërme: poliuteran, shtresa e jashtme kompakte siguron qëndrueshmëri, rezitencë të mirë ndaj ferkimit
- Performancë të lartë dhe fleksibilitet
- Peshë më të lehtë
- Anti – statike (A): siguron minimizimin elektrosatik e bërë për të shmangur riskun e dridhjeve nga korrenti
- Takë absorbuese energjie: siguron komfort dhe qendrueshmeri gjatë ecjes. Eshtë për të absorbuar një nivel minimal energjie për të shmangur tronditjen nga zona e thembrës.
- Siguron qëndrueshmeri në shollë ndaj lagështirës, kohës së ftohtë dhe të nxehtë
- Sholla e jashtme është rezistente ndaj vajit

KËPUCË TAKTIKE VERE DIMRI GORETEX

Këto këpucë janë dizenjuar për operacion në zona rurale dhe interurbane, pasi sigurojnë lëvizshmëri të lartë dhe janë komforte në këmbë.

Këpucët janë shumëfunksionale të përshtatshme për çdo lloj terreni, të përshtatshme për operacione civile dhe trajnim.

Materiali Goretex është prodhuar me mikrofibër dhe tekstil. Pjesa e brendshme e këpucës është me ajrosje aktive.

Certifikuar sipas: CE EN ISO 20345:2011

Klasa e sigurisë: S3

SHOLLA

- E formuar me injeksion direkt: siguron qëndrueshmeri dhe rezistencë
- Shtresa e mesme: poliuteran, siguron mbrojtje dhe komfort si dhe fleksibilitet, peshë më të lehtë dhe izolim ndaj nxehtësisë
- Pjesa e sipërme: poliuteran, shtresa e jashtme kompakte siguron qëndrueshmëri, rezitencë të mirë ndaj ferkimit
- Performancë të lartë dhe fleksibilitet
- Peshë më të lehtë
- Anti – statike (A): siguron minimizimin elektrosatik e bërë për të shmangur riskun e dridhjeve nga korrenti
- Takë absorbuese energjie: siguron komfort dhe qendrueshmeri gjatë ecjes. Eshtë për të absorbuar një nivel minimal energjie për të shmangur tronditjen nga zona e thembrës.
- Siguron qëndrueshmeri në shollë ndaj lagështirës, kohës së ftohtë dhe të nxehtë
- Sholla e jashtme është rezistente ndaj vajit

PELERINE SHIU (PONCHO)

Materiali : 100 % Poliester e veshur me silikon

Ngjyra : BLU

Rezistente ndaj Ujit

Dimesionet : 200 cm ; 168 cm

Pelerina e shiut (Poncho) është e përbërë nga një copë e vetme me dimensione 200 cm me 168 cm e cila është e palosur në mes dhe në qëndër është i qepur një kapuç i cili jep formën e një pelerine shiu (poncho). Anash mbyllet me butona metalike, 4 nga ana e majtë dhe 4 nga ana e djathtë. Në kapuç është i vendosur një shirit me kapëse plastike për rregullimin sipas masës përkatëse.

KAPUÇ MASKIMI

Përbërja e materialit :
NOMEX

Kapuci përbëhet nga dy pjesë :

Pjesa e përparme ka dy vrima për sytë
dhe një për të pjesa e gojës, me fileto rrethuese.

Pjesa e pasme është e thjeshtë.

Të dyja pjesët janë të qepura me
njera - tjetrën .

JELEK OPERACIONAL MULTIFUNKSIONAL

DIZAJNI

Pjesët përbërëse të jelekut operacional multifunksional:

- Tre pjesët e jelekut prej rrjete
- Një xhep me kapak për radion
- Tre xhepa me kapakë për karikatorë për pistoletë dhe mjete të tjera
- Një xhep multifunksional drejtkëndor për gjoksin
- Këllëf i lëvizshëm për saçmet e pushkës teke
- Dy xhepa të përparmë për karikatorë për pushkë automatike
- Dy xhepa të lëvizshëm për pushkë automatike, rezervë
- Një këllëf i lëvizshëm për pistoletë me xhep për karikator të vogël
- Dy xhepa anësor për transportin e karikatorit ose mjeteve të ndryshme: elektrik dore, spraj për lëng lotsjellës, etj.
- Rrip operacional me xhepa multifunksional të lëvizshëm
- Rripa shtrëngues

XHEPAT E BRENDSHËM

Tek zona e abdomenit, brenda, jeleku duhet të jetë i pajisur me dy xhepa të mëdhenj prej rrjete me zinxhir për transportin e materialeve të ndryshme.

AKSESORË TË TJERË

Jeleku duhet të jetë i pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm për fiksimin e aksesorëve të jashtëm si: unaza metalike tek supet, rripat shtrëngues të pozicionuar përgjatë buzës së poshtme të jelekut që shërbejnë për fiksimin e rripit operacional, element velcro femër në shpinë për fiksimin e shkrimit POLICIA dhe sistemi modular me shirita (ALICE) për fiksimin e sistemit hidratues ose aksesorëve të tjerë.

XHEPI I RADIOS

Në anën e majtë të jelekut, në zonën e klavikulës duhet të jetë i pozicionuar xhepi me kapak për transportin e radios. Xhepi duhet të ketë madhësinë e përshtatshme për transportin e radiove të vogla që ka në përdorim Policia e Burgjeve. Mbylljja e kapakut duhet të bëhet me element velcro. Xhepi duhet të jetë gjithashtu i pajisur me vrimë për shkarkimin e ujit.

TRE XHEPAT E VEGJËL

Poshtë xhepit të radios duhet të jenë pozicionuar tre xhepat e vegjël për transportin e karikatorëve të vegjël për pistoletë ose mjeteve të tjera stërgjatëshe si biçak, spraj për lëng lotsjellës, elektrik dore, etj.
Xhepat duhet të kenë madhësinë e përshtatshme për transportin e karikatorëve të pistoletave që ka në përdorim Policia e Burgjeve.

RRIP PANTALLONASH LËKURE

DIZAJNI

Rripi duhet të jetë prej lëkure me ngjyrë të zezë.

Pjesët përbërëse të rripit:

- LËKURA
- TOGËZ KATRORE ME NJË KUNJË
- YLYKËT



LËKURA

Lëkura duhet të jetë 4 mm e trashë tek meshkujt dhe 3 mm e trashë tek femrat. Nga ana e jashtme ajo duhet të jetë pa shkëlqim. Rripi duhet të ketë 6 vrima me diametër 5 mm dhe distancë 25 mm larg njëra - tjetrës. Maja e rripit duhet t'i ketë kulmet e prera. Lëkura duhet të përshkohet nga një tegel perimetral linear një gjil-përësh fals me distancë 3 mm nga buza, për funksion estetik. Tegeli duhet të realizohet nëpërmjet stampimit me të nxehtë në sipërfaqe.

TOGËZA

Forma e togëzës duhet të jetë e njëjtë për të dyja gjinitë. Togëzat e femrave duhet të jenë më të vogla. Togëza dhe kunja duhet të jenë prej nikeli me ngjyrë gri me shkëlqim. Fiksimi i tokëzës tek rripi duhet të bëhet nëpërmjet lëkurës së palosur e të bashkuar me perçinë metalike.

YLYKËT

Rripi duhet të pajiset me dy ylykë për fiksimin e fundit të rripit. Ato duhet të jenë të ndërtuar me të njëjtin material si lëkura e rripit.
Ylykët duhet të jenë rreth 15 mm të gjerë. Trashësia e lëkurës duhet të jetë 3 mm. Një nga ylykët duhet të montohet bashkë me tokëzën, ndërsa ylyku tjetër duhet të jetë i lirë.

ÇORAPE E SHKURTËR

Përbërja e materialit :

90 % Pambuk

7 % Poliester

3% Elastan

ÇORAPE TE GJATA

Përbërja e materialit:

60% Pambuk

35% Poliester

5% Elastan

RRIPI OPERACIONAL MULTIFUNKSIONAL

Materialet bazë që do të përdoren për prodhimin e artikullit rripi operacional multifunksional duhet të jenë të cilësisë së parë, të përshtatshme për funksione operacionale, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	*E zezë*
Përbërja %	*100% najlon*
Pesha e tekstilit të rripit	*850-950 D*
Thurja e tekstilit të rripit	*Oxford*
Thurja e tekstilit të aksesorëve të rripit	*Garniturë*

Pjesët përbërëse të rripit:

- Rripi
- Tokëza plastike
- Ylykët

Aksesorët e rripit:

- Këllëf për pistoletën
- Xhep i dyfishtë me kapak për karikatorët e pistoletës
- Unaza metalike për shkopin të gomës ose elektrikun e dorës
- Xhep me kapak për gypin e alkoolit
- Xhep me kapak për prangat
- Xhep me kapak për spraj me lëng lotsjellës
- Xhep me kapak për radion
- Xhep për teleskopin ose detektorin e metaleve
- Mbajtëse çelësash
- Xhep për dorashkat prej lateksi

Rripi me aksesorët e montuar

Rripi duhet të jetë i tipit operacional (tactical) standard, i pajisur me të gjithë aksesorët e nevojshëm për forcat e policisë në detyrë.

Rripi duhet të ketë mekanizëm shtrëngues për përshtatjen sipas masës së përdoruesit.
Rripi duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj përdorimit të zgjatur, grisjes, abrazionit, etj.
Rripit duhet të mbyllet me anë të tokëzës plastike.
Xhepat duhet të mbyllen me perçina metalike.
Xhepat duhet të jenë të pajisur në pjesën e pasme me ylykë në mënyrë që të vendosen e të hiqen sipas dëshirës.

PARAQITJA, FORMA DHE TË DHËNAT TEKNIKE TË GRADAVE TË DREJTORISE SE PERGJITHESHME TE BURGJEVE

Të dhënat teknike të përgjithshme, GRADA SUPI DHE GJOKSI

Gradat e Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve , sjellin përmirësime cilësore në vlerat estetike e përdoruese të uniformës duke rritur dinjitetin e
punonjësve te Policise se Burgjeve.

Format e Gradave të supit për të gjitha nivelet paraqiten në një tekstil ngjyrë blu të errët të përforcuar nga brenda me një shtresë klorur polivinili (PVC), të palosur në formë trapezi (tubolare). Perimetri i trapezit është i rrethuar (konturohet) nga një kornizë/shirit plastik me ngjyrë të arte i punuar artistikisht në reliev.

Në brendësi të shiritit rrethues janë vendosur në varësi të nivelit të gradës elementet në reliev në material plastik si shirit plastik drejtkëndësh, shirit plastik me motive, yjet me dimensionet të ndryshme, kurore , janë të punuara artistikisht në reliev, imitim qendisje. me ngjyrë të artë. Punimi i gradave është realizuar nga saldimi dhe presioni i duhur në brendësi të stampës të gradës, të gjithë elementeve duke realizuar kështu relievet e vendosura dhe të kërkuara mbi gradë. Vendosja e elementeve në bazë të teknologjisë e punimit bëhet me stampim në të nxehtë dhe në presion të elementeve plastike. Ngjitja e elementeve të veçantë të plastikës duhet të jetë uniform dhe homogjen për të siguruar rezistencën maksimale nga shqitja.

Të gjithë elementet plastike janë në metalizim me fletë metalike të artë duke ruajtur efektin e punimeve të imta që kërkon modeli, ashtu dhe për ruajtjen e shkëlqimit të ngjyrave. Pas kësaj elementet plastike mbrohen nga një fletë plastike të tejdukshme e ngjitur në mënyrë organike me elementet për ta ruajtur nga oksidimet eventuale që mund të vijnë nga agjentët atmosferike. Secila nga grupet janë te specifikuara në raport korelativ të gradës që ajo përfaqëson. për një qëndrueshmëri kohore, fleksibilitet dhe ndjeshmëri

Gradat e mëdha spaleti , janë në formë tubulare dhe me pamje të sipërme trapezoidale. Konkretisht për gradat Inspektor deri në gradat Drejtues i Parë dimensionet janë 60 mm x 58 mm dhe me gjatësi 90 mm, ndërsa për gradat Drejtues i Lartë dhe Drejtues Madhor gjatësia shkon 105 mm. Toleranca e dimensionit apo e pozicionimet të elementëve të gradave është +/- 1mm.

Lënda e parë (Materiali) që do të përdoret është tekstil blu ngjyrë blu i errët, përzierja; 67% pambuk - 33 % fibër poliestër +/- 3%. Pesha e tekstilit 125 gr/m2 +/- 5 gr.

Gradat e vogla të gjoksit, janë në formë drejtkëndëshi me dimension të jashtme të unifikuara prej 86 mm x 30 mm. Toleranca e dimensionit apo e pozicionimet te elementëve te gradave është +/- 1mm. Gradat e gjoksit në pjesën e pasme kanë të qepur në mënyrë solide një material me efekt ngjitës (velkrof-ana mashkull) që e bën gradën të jetë e çmontueshme nga velkrof femër që është e qepur në objektet e uniformës.

E gjithë grada është e veshur për mbrojtje me një fletë plastike transparente, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen nga proceset e oksidimit që vijnë nga agjentët atmosferike.

1. N /INSPEKTOR
2. INSPEKTOR
3. N/KOMISAR
4. KOMISAR
5. KRYEKOMISAR
6. DREJTUES
7. DREJTUES I PARË

GRADË SUPI "N/INSPEKTOR"



GRADË GJOKSI "N / INSPEKTOR"

GRADË SUPI "INSPEKTOR"



GRADË GJOKSI "INSPEKTOR"

GRADË SUPI "K/INSPEKTOR"



GRADË GJOKSI "K/INSPEKTOR"



GRADË SUPI "N/KOMISAR"

Tolerance ±1

GRADË GJOKSI "N /KOMISAR"

Tolerance ±1

GRADË SUPI "KOMISAR"



GRADË GJOKSI "KOMISAR"

GRADË SUPI "K/KOMISAR"



GRADË GJOKSI "K/KOMISAR"

GRADË GJOKSI "DREJTUES I PARË"

Tolerance ±1

GRADË GJOKSI "DREJTUES I PARË"

Tolerance ±1

GRADË SUPI "DREJTUES I PARE"

Tolerance ±1

GRADË GJOKSI "DREJTUES I PARË"

Tolerance ±1

NUMRI I IDENTIFIKIMIT

Tolerance ±1

30mm

86 mm

SHENJA E KAPELES

Shqiponjë dykrerëshe me përkrenaren e Skendërbeut, të vendosur sipër saj. E gjitha e artë, me reliev dhe e stilizuar sipas figurës.

60mm

50mm

SHENJË KRAHU POLICIA E BURGJEVE

70mm

80mm

SHENJË KRAHU POLICIA E BURGJEVE, FORCAT SPECIALE

70mm

80mm

SHENJË KRAHU POLICIA E BURGJEVE

SHENJA E JAKËS

KOPSAT

Kopsa të vogla
15 mm

Kopsa të vogla
23 mm

Kopsa të vogla
25 mm